

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7151
E martë, 26 mars 2024
Çmimi 0.50

Në SBASHK shtohen
kërkesat për t'i rikthyer
protestat e grevat



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

KONJUFCA: OPSIONI MË I MIRË ËSHTË TË SHKOHET NË ZGJEDHJE TË REJA



Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, duke komentuar kërkesën e partive të opozitës për zgjedhje të parakohshme parlamentare, ka thënë të hënën se

ai moti ka përkrahur idenë që vendi të shkojë në zgjedhje. "Ju e dini që unë moti jam për zgjedhje. Kam thënë që opsioni më i mirë është të shkohet në zgjedhje", ka deklaruar

Konjufca. Përfaqësuesit e opozitës edhe të hënën kanë përsëritur kërkesën për zgjedhje të parakohshme, duke kërkuar dorëheqjen e kryeministrit Kurti

**KURTI:
ELIMINIMI
I KORRUPSIONIT
VARET NGA
PROKURORIA
DHE GJYQËSORI**

F. 3



**ISH-DIPLOMATI
AMERIKAN:
UÇK-ja NUK
KISHTE INFLUENCË
MBI KOMANDANTËT
E ZONAVE**

F. 5



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mobi: +377 44 501289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SPORT



**DREJTUESIT E FFK-së VIZITOJNË
AMBASADËN E KOSOVËS NË BUDAPEST**

F. 12

**Kolegji
BIZNESI**

www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Këshilli i Sigurimit miraton rezolutën që kërkon “armëpushim të menjëhershëm” në Gazë

NJU-JORK, 25 MARS - Për herë të parë Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara miratoi një rezolutë që kërkon armëpushim në Gazë.

Shtetet e Bashkuara, aleate të Izraelit, që më herët kishin vendosur veto ndaj rezolutave të prezantuara, abstenuan gjatë votimit të 25 marsit.

Rezoluta, që kërkon “armëpushim të menjëhershëm” gjatë Muajit të Ramazanit, që do të çonte në një armëpushim “të qëndrueshëm”, u miratua pasi të gjithë 14 anëtarët e tjerë të Këshillit të Sigurimit votuan pro saj.

Një ndryshim qëndrimi ndaj aleatit në Lindjen e Mesme u pa të premtën, kur ShBA-ja prezantoi një rezolutë që kërkonte një “armëpushim të menjëhershëm dhe të qëndrueshëm”. Megjithatë,

rezoluta u bllokua nga Rusia dhe Kina, së bashku me shtetet arabe që kritikuan tekstin e rezolutës, pasi argumentuan se aty në mënyrë eksplicite nuk iu kërkuar Izraelit që ta ndalë fushatën e tij ushtarake në Gazë. Në rezolutën e re, të miratuar të hënën, kërkohet “një armëpushim i menjëhershëm” gjatë Muajit të Ramazanit që do të çonte “në një armëpushim të qëndrueshëm dhe të përhershëm”.

Rezoluta, po ashtu, kërkon “lirim të menjëhershëm dhe pa kushte të të gjitha pengjeve” si dhe heqjen “e pengesave që do ta mundësonte dërgimin e ndihmës humanitare”.

Rezoluta është hartuar nga anëtarët jo të përhershëm të Këshillit, të cilët kanë negociuar gjatë fundjavës me ShBA-në për ta shmangur vendosjen e vetos, thanë burimet diplomatike, që u



shprehën optimiste se rezoluta do të kalonte.

ShBA-ja vazhdimisht ka bllokuar rezolutat për armëpushim, përderisa ka vazhduar të mbështesë Izraelin, por ka shprehur frustrim me

kryeministrin izraelit Benjamin Netanyahu për shkak të numrit të madh të viktimave në Rripin e Gazës.

Por, rezoluta e re, tashmë e miratuar, nuk është e lidhur me bisedimet që po vazhdojnë, që

udhëhiqen nga Katar dhe mbështeten nga ShBA-ja dhe Egjipti. Këto bisedime synojnë ndaljen e luftimeve në këmbim që Hamasi - grupi palestinez i shpallur organizatë terroriste nga ShBA-ja dhe Bashkimi Evropian - që t'i lirojë pengjet.

Lufta në Gazë nisi pasi Hamasi sulmoi jugun e Izraelit më 7 tetor, duke vrarë afër 1 200 persona dhe duke rrëmbyer afër 250 të tjerë. Si pasojë e ofensivës izraelite në Rripin e Gazës janë vrarë mbi 32 000 persona, shumica gra dhe fëmijë, sipas Ministrisë së Shëndetësisë në enklavën e udhëhequr nga Hamasi.

Deri më tani Këshilli i Sigurimit ka miratuar dy nga tetë rezolutat e paraqitura për luftën Izrael - Hamas. Rezolutat e miratuara kryesisht kishin të bënin me dërgimin e ndihmës humanitare.


Rregullatorët evropianë nisin hetim kundër Apple, Google dhe Meta

BRUKSEL, 25 MARS - Rregullatorët evropianë i kanë nisur hetimet kundër kompanive Apple, Google dhe Meta të hënën.

Ky është rasti i parë i hetimeve në përputhje me ligjin e ri - që hyri në fuqi këtë muaj - i cili ka për qëllim të mos i lejojë kompanitë e mëdha të teknologjisë ta kontrollojnë tregun digjital.

Komisioni Evropian tha se po i heton këto kompani për “mosbindje” ndaj Aktit të Tregjeve Digjitale (ATD).

Akti i Tregjeve Digjitale është një ligj i gjerë i cili i ka në shënjestër kompanitë e mëdha të teknologjisë që ofrojnë “shërbime të platformës kryesore” duke i detyruar ato



t'u përmbahen një sërë rregullash se çfarë duhet të bëjnë dhe çfarë jo. Nëse nuk i përmbahen ligjit, ato rrezikojnë ndëshkime të ashpra financiare, e madje

edhe me mbylljen e bizneseve. Rregullat kanë për qëllim t'i bëjnë tregjet digjitale “më të drejta” dhe “më të kontestueshme”, duke i prishur ekosistemet e mbyllura

teknologjike të cilat i detyrojnë myshterijntë të përdorin produkte apo shërbime të një kompanie të vetme.

Rregullatorët po hetojnë nëse Google dhe Apple po u përmbahen plotësisht rregullave të ATD-së, të cilat kërkojnë që këto kompani t'i lejojnë zhvilluesit e aplikacioneve t'i drejtojnë përdoruesit kah ofertat në dispozicion jashtë dyqaneve të tyre të aplikacioneve.

Komisioni Evropian tha se ndihet i shqetësuar se këto dy kompani janë duke vendosur “kufizime të ndryshme”, përfshirë pagesa që ua parandalojnë aplikacioneve promovimin e ofertave falas. Google përballet me kritika se

nuk po u përmbahet rregullave të ATD-së, të cilat u ndalojnë kompanive gjigante t'i bëjnë preferenca shërbimeve të veta karshi atyre rivalëve.

Komisioni tha se është duke e hetuar kompaninë Apple gjithashtu për të parë nëse ajo po bën mjaftueshëm për t'i lejuar përdoruesit e iPhone t'i ndryshojnë me lehtësi ueb-brouserat.

Ndërkohë, Meta po hetohet për një opsion i cili u mundëson përdoruesve të paguajnë një shumë mujore për versione pa reklama të Facebook dhe Instagram, në mënyrë që ta shmangin përdorimin e të dhënave personale kur targetohen me reklama online.

Irani shqyrton mundësinë e shqiptimit të gjobave për shkeljen e kodit të veshjes

Tehran, 25 mars - Një ligjvënës iranian tha se autoritetet po diskutojnë që të vendosin dënime financiare për shkeljen e rregullit për vendosjen e detyruar të hixhabet si një mënyrë për t'u larguar nga burgosja apo ndjekja penale ndaj keqbërësve të perceptuar.

Ky njoftim ndodh në kohën kur ka pakënaqësi në rritje në mesin e iranianëve pas një vale të shtypjes të protestave që u nxitën nga vdekja e Mahsa Aminit, gjatë paraburgimit më 2022. Amirhossein Bankipour i tha

televizionit shtetëror se është arritur konsensus për këtë hap në mesin e trupave kyçe qeveritarë dhe të sigurisë.

Bankipour tha se kjo lëvizje vjen pas vlerësimeve që gjetën se patrullimet e “policia e moralit” dhe ndëshkimet penale nuk kanë qenë efektive dhe kanë nxitur protesta. Organet qeverisëse, përfshirë Këshillin Suprem të Revolucionit Kulturor dhe Këshillin Suprem të Sigurisë Kombëtare, gjetën se gjobat ishin mjet më pak konfrontues për të zbatuar

kodin e veshjes, tha ai.

Bankipour muajin e kaluar la të kuptohet se në të ardhmen do të prezantohet një projektligj i ri për hixhabin, që do të gjobiste shkelësit me 30 milionë rialë iranianë (50 dollarë). Ai tha se gjobat do të merreshin drejtpërdrejtë nga llogaritë bankare të shkelësve, si dhe do të kishte gjoba shtesë për përsëritjen e shkeljeve.

Megjithatë, një zëdhënës i policisë tha se ende nuk kanë marrë ndonjë njoftim zyrtar për gjobat.



Ish-diplomati amerikan: UÇK-ja nuk kishte influencë mbi komandantët e zonave

HAGË, 25 MARS - Shaun Byrnes, ish-shef i misionit diplomatik vëzhgues të Amerikës në Kosovë, është dëshmitari i 53-të në rastin e krerëve të UÇK-së në Hagë. Në nisje të dëshmisë, ai ka thënë se ka ardhur si dëshmitar jo me vetiniciativë, por pasi i është kërkuar nga Departamenti Amerikan i Shtetit. "Dëshiroj të them që jam këtu me kërkesën e Departamentit të Shtetit dhe Prokurorisë së Specializuar. Nuk kam ardhur këtu me nismën time vetjake, megjithatë e pranoj përgjegjësinë që të jap dëshmi duke marrë parasysh pozicionin tim dhe përgjegjësitë e mia në Kosovë në vitet 1998-1999", ka thënë ai, raporton "Nacionale". Gjatë marrjes në pyetje, Byrnes ka folur edhe për rolin e Thaçit në kohën e luftës dhe takimet që ka pasur me të. "Është gjysmë e saktë. Asnjëherë nuk mbaj në mend që Thaçi të jetë marrë në mënyrë të drejtpërdrejtë me komandantët në terren. Ne e kemi takuar me pjesëtarë të tjerë të Drejtorisë Politike dhe, sipas

përkufizimit, jo udhëheqës ushtarakë", ka thënë Byrnes. Ai ka thënë se "shtabi i përgjithshëm ka qenë si Ministria e Jashtme e UÇK-së". "Kjo ka qenë ndjesia", ka thënë ai, duke treguar edhe ndërveprimin që kishte UÇK-j me faktorin ndërkombëtar. "Kishte dy grupe në diasporë: një grup që ishte pro çlirimit dhe shndërrimit të saj në shtet të pavarur. Kishte një grup tjetër i cili ishte opsioni 1 plus 1, çlirimi nga Serbia dhe ribashkimi me Shqipërinë. Këta nga diaspora u kthyen në Kosovë nga Zvicra dhe ata ofruan ndërveprimin me komunitetin ndërkombëtar. Sepse ata kuptuan faktin që pas Dejtonit më 1995, Kosova kishte pak gjasa që të bëhej e pavarur. Këta zotëri si Thaçi e Haliti u kthyen", ka thënë Byrnes.

Ai ka folur edhe për organizimin e disa zonave, duke thënë se komandantët ishin kundër të futeshin nën urdhrat e shtabit të përgjithshëm. "E dinim se kishte rezistencë për riorganizimin e



zonave. Në veçanti Remi dhe disa komandantë të zonave, dhe z. Ramush Haradinaj, ata të dy na kishin thënë se ishin kundër riorganizimit. Dhe ishin kundër

që të ishin të varur nga shtabi i përgjithshëm që u organizua diku nga fundi i verës. Ata kishin këtë qëndrim sepse kishin mundësi të rezistonin. Kishin

burimet e veta, financimet e veta. UÇK-ja nuk kishte influencë mbi këta persona. Këta persona ishin të pavarur", ka thënë ai.

Kurti: Eliminimi i korrupsionit varet nga prokuroria dhe gjyqësori

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 25 MARS - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, duke u bazuar në raportin e organizatës Transparency International, ka treguar se si qeveri kanë arritur të renditen më lart për 21 vende sa i përket luftimit të korrupsionit. "Ka më shumë sundim të ligjit. Korrupsioni po luftohet. Në indeksin e Transparency International mbi Perceptimin e Korrupsionit jemi përmirësuar për 21 vende në tri vjet dhe qëndrojmë në renditjen më të lartë ndonjëherë. Eliminimi i tij varet nga prokuroria dhe gjyqësori", ka shkruar Kurti në "Facebook". Ai ka bërë me dije se mbi 2.4 tonë substanca narkotike janë konfiskuar nga Policia e Kosovës. "Afër 37 milionë euro



mall dhe asete të sekuestruara dhe konfiskuara nga operacionet e Doganës së Kosovës. Numri i inspektimeve nga Inspektorati Qendror i

Mbikëqyrjes së Tregut është rritur për rreth 63 % në krahasim me vitin 2019 - shifër kjo rekord e inspektimeve. Paraja publike shpenzohet me

përgjegjësi dhe ruhet e mbrohet gjithashtu. Mbi 145 milionë euro i janë kursyer buxhetit të Kosovës nga tri procese të fituara në arbitrazhin ndërkombëtar", ka thënë Kurti. Kryeministri ka theksuar se në veri të vendit është ulur ilegaliteti, e po shtohen ligjshmëria dhe siguria. "Janë mbyllur 27 rrugë ilegale, dhe janë shkatërruar 9 laboratore droge, 6 të kriptovalutave dhe 4 depo të armatimit. Janë sekuestruar alarme e kamera të strukturave ilegale, dhe armatim e asete në vlerë rreth 15 milionë euro nga hetimet mbi sulmin terrorist dhe paramilitar të 24 shtatorit, ku humbëm rreshterin shembullor Afrim Bunjaku por fituam një Hero të Kosovës dhe dolëm fitues e faqebardhë", ka theksuar ai.

Kurti ka thënë se në veri tash janë ngritur 9 stacione policore për mbikëqyrjen dhe kontrollin e kufirit, e nuk kishte asnjë deri në vitin 2021. "Pas 24 vjetëve në komunat veriore janë hapur e funksionalizuar zyrat e Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës dhe të Kadastrave Komunale në shërbim të qytetarëve dhe të bizneseve të ligjshme. Me largimin e targave ilegale, siguria publike është më e mirë. Po shtohen rrugë që lidhin fshatrat mes vete në veri e me komuna në jug, po ndërtohen e rinovohen shtëpi të banorëve, e po modernizohet infrastruktura e telekomunikimit dhe internetit për shërbimet 4G+ dhe 5G. Qeverisje e sundimit të ligjit, e të gjithëve, pa dallim", ka thënë ndër të tjera kryeministri Kurti.

Kosova dhe Serbia, "dallime të mëdha" për dinarin

BRUKSEL, 25 MARS - Kosova dhe Serbia kanë përfunduar të hënën edhe një raund bisedimesh pa arritur përparim për çështjen e dinarit serb, përdorimi i të cilit është ndaluar më 1 shkurt në Kosovë. Kryenegociatori i Kosovës, Besnik Bislimi, tha se dallimet janë të mëdha dhe kërkohet një takim shtesë, ndërkaq ai i Serbisë, Petar Petkoviç, kritikoi Prishtinën se nuk po bën përpjekje për të arritur një zgjidhje kompromisi.

Bislimi, pas takimit me Petkoviçin në ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian, tha se janë diskutuar propozimet e palëve për çështjen e dinarit. "U pa se ka një dallim të madh mes propozimeve të të dyja palëve dhe u dakorduam që, pas disa bisedimeve, që ka nevojë edhe për një takim të radhës, për të parë se a ka mundësi të afrohem drejt një zgjidhje apo jo", tha Bislimi. Bislimi nuk dëshoi të japë hollësi për propozimet, pasi argumentoi se do të dëmtohej

procesi negociues, por tha se ai i Kosovës ishte "konstruktiv". "Mendoj se pala jonë ka nxjerr një propozim shumë konstruktiv që mundëson që mbështetja financiare të shkojë te përdoruesit finalë, por pa u lënduar në asnjë moment rregullorja e BQK-së dhe korniza legjislative e vendit tonë", tha Bislimi. Por, kryenegociatori i Serbisë, Petar Petkoviç, tha se propozimi i Prishtinës nuk çon drejt një zgjidhje kompromisi.





Konjufca: Opsioni më i mirë është të shkohet në zgjedhje të reja

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, duke komentuar kërkesën e partive të opozitës për zgjedhje të parakohshme parlamentare, ka thënë të hënën se ai moti ka përkrahur idenë që vendi të shkojë në zgjedhje. “Ju e dini që unë moti jam për zgjedhje. Kam thënë që opsioni më i mirë është të shkohet në zgjedhje”, ka deklaruar Konjufca. Përfaqësuesit e opozitës edhe të hënën kanë përsëritur kërkesën për zgjedhje të parakohshme, duke kërkuar dorëheqjen e kryeministrit Kurti

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 25 MARS -

Kryeparlamentari Glauk Konjufca ka thënë se ka mendim të njëjtë me opozitën për ta dërguar vendin në zgjedhje, veçse ka kërkuar pajtim me partitë politike për ta gjetur kohën e përshtatshme. Ai ka thënë se kërkesë specifike nga partitë politike nuk ka pasur, por që nuk e përjashton mundësinë për një gjë të tillë.

Konjufca ka thënë se duhet pajtim me partitë politike për ta dërguar vendin në zgjedhje të reja. “Sot e patëm mbledhjen e Kryesisë. E përfunduam dhe nuk pashë asgjë nga këto kërkesa, por nuk e përjashtoj që në të ardhmen ndonjë grup parlamentar mund ta fillojë mbledhjen e nënshkrimeve. Ju e dini që unë moti jam për zgjedhje. Kam thënë që opsioni më i mirë është të shkohet në

zgjedhje. Të gjithë po thonë se është sivjet, por ky vit i ka edhe disa muaj. Nuk mund t’ju them saktë se cila është koha më e mirë për të shkuar në zgjedhje, mirëpo e keni dëgjuar edhe kryeministrin që ka thënë se do të ishte në mbështetje të një iniciative të opozitës sa i përket shkuarjes në zgjedhje. Vetëm duhet të ulemi me partitë politike dhe ta specifikojmë se cila është koha më e përshtatshme, a është vera apo vjeshta”, ka thënë Konjufca.

Shefja e grupit parlamentar e LV-së, Mimoza Kusari-Lila, ka thënë se si subjekt politik nuk do ta mbështesin kërkesën për mocion mosbesimi ndaj qeverisë të një grupi parlamentar individualisht. Ajo u shpreh se nuk ka konsensus brenda partive të opozitës. “Tri grupet parlamentare të opozitës kanë 42 vota bashkë, 2 vota janë të deputetëve të pavarur. Nëse 44 votave nuk iu bashkohen 16 vota

të LV-së sipas deklaramit të tyre, atëherë shanset për çfarëdo suksesi të mocionit janë të vogla”, ka thënë Kusari-Lila.

Ajo ka shtuar se në anën tjetër ka kërkesa për dorëheqje dhe shpërbërje të Kuvendit që duhen 2/3 e votave. “Të gjitha këto nuk mund të bëhen në nivelin e deklaramive politike nga grupime të veçanta për të caktuar një datë të zgjedhjeve në një datë më të afërt sesa zgjedhjet e rregullta”, ka thënë Kusari-Lila.

Shefja e deputetëve të LV-së ka thënë se duhet të ketë edhe seriozitet dhe përkushtim të partive politike për dialog të mirëfilltë. “Përderisa grupet politike të opozitës nuk e kanë këtë duket pak joserioze të kërkojnë votat e pozitës për ta shpërndarë Kuvendin apo për ta mbështetur mocionin e mosbesimit”, ka deklaruar Kusari-Lila.

Deputetja e Partisë Demokratike të

Kosovës, Blerta Deliu-Kodra, ka thënë të hënën se partia e saj tash e sa kohë ka kërkuar që vendi të shkojë sa më parë në zgjedhje. Siç tha ajo, kjo duhet të ndodhë pasi, sipas saj, i ka humbur kuptimi kësaj qeverie. “PDK-ja ka thënë tash e sa kohë që vendi duhet të shkojë sa më parë në zgjedhje sepse i ka humbur kuptimi kësaj qeverie. Relacionet me partnerët janë më të rëndat ndonjëherë. Shëndetësia është në kolaps, arsimi është pa progres, vendi duhet të shkojë në zgjedhje sa më shpejt. Nuk ka asnjë projekt për të cilin kjo qeveri mund të deklarohet që ka përmbushur”, ka thënë deputetja e PDK-së.

Ajo ka thënë se kryeministri nuk ka qeverisur. “Nuk ka asnjë projekt në asnjë dikaster për të cilin ne sot mund të flasim. Ka një dorëzim. Kryeministri tha edhe vetë që do t’u hapë rrugë zgjedhjeve të reja. Partitë opozitare do ta gjejnë mënyrën që t’u japin rrugë zgjedhjeve të reja. Ato duhet të ndodhin sepse nuk ka asnjë progres për të cilin kjo qeveri mund të krekoset”, ka thënë Deliu-Kodra.

Shefi i grupit parlamentar i LDK-së, Arben Gashi, ka thënë se qeverisja e Albin Kurtit po shkon drejt fundit. Ai ka thënë të hënën se qytetarët duhet të përgatiten për zgjedhje.

“Zgjidhja të cilën ne konstatojmë është se kryeministri duhet t’u japë mundësi qytetarëve të gjejnë zgjidhje. Ai duhet të dorëhiqet dhe pastaj ne ta shpërndajmë Kuvendin. Kurti duhet ta krijojë situatën e re politike me dorëheqje. Kryeministri është i dorëzuar politikisht, juridikisht, i tërhequr administrativisht, i paaftë në qeverisje, mbetet edhe formalizimi i dorëheqjes dhe tërheqjes së tij nga ky mandat”, ka thënë Gashi. Ndërsaq shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, ka thënë se në seancën e së enjtes ku do të flitet për themelimin e Komisionit Hetimor Parlamentar për kontratat njëburimore do ta kërkojnë edhe dorëheqjen e kryeministrit Albin Kurti.

Tahiri ka thënë se kryeministri Kurti është dorëzuar. “Një kryeministër që ka një plan qeverisës, objektiva qeverisëse dhe synime që t’i përmbushë projektet ai nuk flet për zgjedhje të parakohshme. Në momentin që flet për zgjedhje është dorëzim i tij, dhe ajo që duhet të ndodhë është shkarkimi ose dorëheqja e tij”, ka deklaruar Tahiri.

Ai shtoi se kryeministri nuk duhet të bëjë komunikim publik dhe të mundohet që topin ta adresojë tek opozita. “Le të viktimizohet, qytetarët e dinë që problemi në

Në Mal të Zi paralajmërojnë votë kundër pranimin të Kosovës në Këshillin e Evropës

PRISHTINË, 25 MARS - Partia Demokratike Popullore (PDP) në pushtet në Mal të Zi e ka mbështetur deputeten e vet, Maja Vukiçević, për kryetare të delegacionit malazez në Asambllën Parlamentare të Këshillit të Evropës (APKE), për të votuar kundër pranimin të Kosovës në këtë organizatë. "Përkrahja e plotë është shprehur nënkryetares së partisë, Maja Vukiçević, kryetare e delegacionit malazez në APKE, që të votojë kundër pranimin të së ashtuquajturës Kosovës në Asambllën Parlamentare të Këshillit të Evropës", thuhet në deklaratën e partisë të publikuar më 24 mars.

PDP-ja është një nga anëtarët e Frontit Demokratik (FD) të shpërbërë proruse dhe proserb dhe përbën shumicën parlamentare në Mal të Zi, e cila udhëhiqet nga Lëvizja Evropa Tani e kryeministrit Millojko Spajiq. Kjo parti, e udhëhequr nga njëri prej liderëve të ish-FD-së, Millan Knezheviq, avokon për tërheqjen e njohjes së pavarësisë së Kosovës, daljen e Malit të Zi nga NATO-ja dhe heqjen e sanksioneve kundër Rusisë.

Kur erdhi në pushtet në fund të vitit

të kaluar, PDP-ja njoftoi se nuk do t'i ngrinte këto çështje.

Në marrëveshjen e koalicionit me Lëvizjen Evropa Tani të kryeministrit Spajiq, palët, ndër të tjera, u pajtuan që qeveria të mos merrte vendime që do të vinin në pikëpyetje pavarësinë e Kosovës, sanksionet kundër Rusisë për shkak të pushtimit të Ukrainës, dhe detyrimet ndaj NATO-s.

Kosova u njoh në vitin 2008 nga Qeveria e Partisë Demokratike të Socialistëve, Millo Gjukanoviç, e cila në gusht të vitit 2020 humbi zgjedhjet ndaj FD-së proserbe dhe proruse, Demokratëve dhe lëvizjes URA.

Delegacioni i Malit të Zi në Asambllën Parlamentare të Këshillit të Evropës përbëhet nga gjashtë anëtarë, nga të cilët katër janë anëtarë të qeverisë dhe dy anëtarë të opozitës.

Këshilli i Ministrave të Këshillit të Evropës e dorëzoi në Asambllën Parlamentare kërkesën e Kosovës për anëtarësim në këtë organizatë në prill të vitit 2023 dhe kështu nisën zyrtarisht procedurat për shqyrtimin e aplikacionit të Kosovës.

Pro kërkesës së Kosovës votoi edhe përfaqësuesi i Malit të Zi. Për këtë



reaguan ashpër një pjesë e partive proserbe në pushtet.

Të pakënaqur me faktin se Mali i Zi votoi për pranimin e Kosovës në Këshillin e Evropës, deputetët e FD-së kërkuan një seancë dëgjimore të kryeministrit dhe ministrit të Punëve të Jashtme të atëhershme, Dritan Abazoviç.

Interesi i Malit të Zi për ta mbështetur anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës është në mirë të stabilitetit dhe bashkëpunimit rajonal, kishte

thënë Abazoviç gjatë seancës së Komisionit për Marrëdhënie Ndërkombëtare të Parlamentit të Malit të Zi në maj 2023.

Anëtarësimi i Kosovës në Këshillin e Evropës është riaktualizuar në javët e fundit, pasi, me kërkesën e Qeverisë së Kosovës drejtuar Agjencisë Kadastrale për transferimin e 24 hektarëve tokë në emër të Manastirit të Deçanit, është përmbushur një nga kushtet kryesore për anëtarësim. Kjo çështje mund të jetë vendimtare

për kërkesën e Kosovës për anëtarësim në Këshillin e Evropës gjatë Asambllës Parlamentare të atij institucioni që do të mbahet në prill.

Nëse Kosova merr dritën jeshile në Asambllën Parlamentare, atëherë fjalën përfundimtare duhet ta japë Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës - gjë që Qeveria e Kosovës pret të ndodhë në maj.

Në maj të vitit 2022 Kosova aplikoi për anëtarësim në Këshillin e Evropës. (REL)

Në SBASHK shtohen kërkesat për t'i rikthyer protestat e grevat

PRISHTINË, 25 MARS - Në takimin e rregullt me kryetarët e nivelit komunal dhe të universiteteve që ka organizuar SBASHK-u janë zhvilluar biseda për situatën aktuale në arsim dhe janë hedhur vërejtje e kritika të shumta në adresë të Qeverisë Kurti për mungesë të dialogut, për qasjen e gabueshme ndaj sindikatave dhe kërkesave të anëtarësisë dhe për tendencën e ministrit Murati që të mohojë me ndryshime të ligjeve aktuale të drejtat e fituara të punëtorëve të arsimit. Kështu është bërë me dije në njoftimin e Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK) për medie. "Në këtë takim është kritikuar edhe ngritja ironike e koeficientit të pagës nga 105 në 110 euro duke e cilësuar si nënçmuese ngritjen prej vetëm 28 euro të pagave në sistemin arsimor parauniversitar.



Përfaqësuesit e të punësuarve në tërë sistemin arsimor, që nga çerdhet e deri në universitete kanë paraqitur gjithë shqetësimet dhe kërkesat e anëtarësisë para kryetarit të SBASHK-ut Rrahman Jasharaj dhe stafit qendror dhe pas diskutimeve të shumta të gjithë

kanë ardhur në përfundim se duke parë qëndrimin negativ të Qeverisë Kurti ndaj sindikatave dhe zërit të anëtarësisë dhe duke parë se ministri Murati vazhdon angazhimet kundër dialogut sindikal duke bllokuar punën e Këshillit Ekonomik Sindikal, duke

parë se po vazhdon bllokimi i nënshkrimit të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive, duke parë se ministri Nagavci vazhdon me inatet dhe nuk përfaqëson kërkesat e punëtorëve të arsimit dhe mundohet ta mohojë edhe Kontratën Kolektive për Arsimin e Kosovës, pjesëmarrësit në këtë takim kanë nxjerr si përfundim se duhet vazhduar me bashkëbisedat me anëtarësinë dhe duhet rikthyer veprimet sindikale duke filluar me një protestë me gjithë udhëheqësit sindikal të shkollave, çerdheve dhe universiteteve e institucioneve të kulturës e nëse Qeveria Kurti vazhdon me qasjen e njëjtë injoruese atëherë të vazhdohet me veprime sindikale duke paralajmëruar se do të përsëritet viti 2022 me një grevë të përgjithshme më 1 shtator, e cila do të vazhdojë deri në plotësimin e

plotë të kërkesave të anëtarësisë", është theksuar në njoftimin për medie.

SBASHK-u ka njoftuar se "me këtë alarm publik iu drejtohet edhe medieve, shoqërisë civile, deputeteve e deputetëve dhe gjithë qytetarëve të Kosovës që ta ngritin zërin dhe të kërkojnë nga Qeveria që të ndryshojë qasjen ndaj dialogut dhe të realizojë kërkesat e anëtarësisë së SBASHK-ut dhe sindikatave tjera sepse në të kundërtën do të kthehet ajo që ndodhi në vitin 2022 kur tërë sistemi arsimor ishte në veprime sindikale e pastaj edhe në grevë të përgjithshme, e cila fatkeqësisht zgjati më shumë se një muaj. Nëse Qeveria vazhdon kështu, atëherë protestat e grevat do të rikthehen dhe fajtorët janë kryeministri Kurti, ministri Murati e ministri Nagavci dhe jo vetëm".

Kosovë nuk është Kuvendi, por qeveria", është shprehur Tahiri. I pyetur se cilat janë mënyrat për rrëzimin e Kurtit nga pushteti, Tahiri u shpreh se përmes petitionit nuk mund ta bëjnë një gjë të tillë. Ai u shpreh se janë tri mënyra për rrëzimin e Kurtit nga pushteti. "E para është dorëheqja, e dyta përmes mocionit të mosbesimit dhe e treta shpërndarja e Kuvendit. Ne si AAK kemi kërkuar që një vit e

gjysmë që të shkarkohet Kurti përmes një mocioni mosbesimi", ka thënë Tahiri.

Javën e kaluar kryeministri Albin Kurti ka thënë se nëse opozita dëshiron zgjedhje të reja, atëherë është i gatshëm të ulet dhe të bisedojnë së bashku për shpërndarjen e Kuvendit, por ka thënë se rrëzim të qeverisë nuk do të ketë. "Nuk kam deklaruar ashtu, por i jam përgjigjur pyetjes së gazetares. Shtrohet pyetja pse

më ka pyetur gazetarja. Ajo më ka pyetur sepse ka presupozuar dëshirën e opozitës. Nëse nuk do të kishte dëshirë të opozitës, nuk do të kishte pyetje të gazetares dhe, rrjedhimisht, nuk do të kishte përgjigje timen. Pra, gjithçka ndërtohet mbi hipotezën që opozita dëshiron zgjedhje të parakohshme dhe unë kam shprehur gatishmërinë time që nëse opozita dëshiron zgjedhje të parakohshme, mund

ta bëjmë me 2/3 e votave të Kuvendit shpërndarjen e Kuvendit dhe të shkojmë në zgjedhje. Nëse opozita është rehat, ne jemi edhe më rehat. Pra, ne po qeverisim mbarë e mirë dhe këto janë të arritura. Jemi rehat në punën që bëjmë. Pra, vetëm nëse opozita do zgjedhje, ne jemi të gatshëm të ulemi e të bisedojmë për shpërndarjen e Kuvendit dhe të shkojmë në zgjedhje, por nuk ka pse të

rrëzohet qeveria. Qeveria e mbarë e mirë nuk rrëzohet. Qeveria vazhdon, mirëpo nëse opozita është e interesuar që të mos i kemi ne 12 muaj në vitin e fundit, por të kemi më pak muaj, atëherë jemi të gatshëm të ulemi dhe ta bëjmë shpërndarjen e Kuvendit, por jo ta rrëzojmë qeverinë", ka thënë Kurti. Ai ka thënë se dëshira e tij është që ta vazhdojë qeverisjen. "Dorëheqje nuk jap", ka thënë Kurti.

KDI-ja: Komisionit për Rezerva i ka skaduar mandati më 21 mars

PRISHTINË, 25 MARS - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka bërë me dije se Komisionit për Rezerva i ka skaduar mandati më 21 mars, duke theksuar se mbledhja që ka mbajtur të hënën ky komision ishte e paligjshme. "Komisioni Hetimor Parlamentar për skandalin me rezervat

shtetërore në Ministrinë e Tregtisë mbajti mbledhjen e radhës, në shpërputhje me Ligjin për Hetim Parlamentar. Kjo sepse mandati i këtij komisioni ka përfunduar me 21 mars të këtij viti, pasi kanë kaluar 6 muaj nga data e themelimit të tij nga Kuvendi me 21 shtator 2023. Ligji për

Hetim Parlamentar e thotë shprehimisht që Komisioni hetimor themelohet në datën e marrjes së vendimit të Kuvendit për themelimin e tij dhe mandati i tij është 6 muaj", është thënë në reagimin e KDI-së.

Më tej theksohet se, sipas ligjit, në mënyrë që Komisionit

Hetimor t'i vazhdohet mandati, kryetari i komisionit duhet t'i drejtohet me kërkesë Kryesisë së Kuvendit, pas aprovimit të së cilës vazhdimi i mandatit të Komisionit Hetimor duhet të votohet në seancë. "Prandaj, çdo mbledhje e këtij Komisioni që mbahet pa iu vazhduar



mandati nga Kuvendi, duke përfshirë edhe atë të mbajtur sot, janë të jashtëligjshme", është thënë në reagimin e KDI-së.

Hapet ekspozita "Kosova në gjuhët e botës"

PRISHTINË, 25 MARS - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, mori pjesë në ekspozitën "Kosova në gjuhët e botës", hapur nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës me rastin e 25-vjetorit të sulmeve ajrore të forcave të NATO-s kundër Serbisë dhe Jugosllavisë.

Konjufca tha se ndien kënaqësi të veçantë që po merr pjesë në hapje të kësaj ekspozite, në veçanti në 25-vjetorin e sulmeve ajrore të NATO-s në ish-Jugosllavi. "Përkimi i kësaj ekspozite të librave të shkruara për Kosovën në gjuhë të huaja, me luftën që NATO e nisi për ta shpëtuar popullin e Kosovës nga spastrimi etnik dhe gjenocidi, na nxit domosdoshmërisht të reflektojmë se lufta e popujve për liri e çlirim, e veçanërisht e popujve të vegjël, gjithnjë duhet të zhvillohet në shumë fronte, sepse ajo shumë shpesh varet nga aleanca dhe mbështetja e popujve dhe shteteve të mëdha", tha Konjufca.

Kreu i Kuvendit shtoi se sensibilizimi i opinionit botëror për çështjen e Kosovës dhe të



drejtën e saj për liri dhe pavarësi nga Serbia ka qenë një front i rëndësishëm për realizimin e aspiratave të popullit shqiptar dhe se ishin autorët e huaj, përkatësisht kontributi i tyre, që ndikoi padyshim në krijimin e një opinioni pozitiv në botë për lirinë e shqiptarëve. "Kjo ka qenë veçanërisht e rëndësishme edhe për faktin se propaganda serbe kundër Kosovës në qarqet evropiane e perëndimore ka

qenë e hershme dhe intensive. Pavarësisht kontributit që elitat tona intelektuale, duke përfshirë edhe shumë anëtarë të nderuar të kësaj Akademie, kanë dhënë në përhapjen e të vërtetës shkencore e historike për Kosovën dhe çështjen e pazgjidhur shqiptare në Ballkan, kontributi i autorëve të huaj, miqve të Kosovës, shumë prej të cilëve kanë bartur edhe detyra të larta drejtuese, ka ndikuar

padyshim në krijimin e opinionit pozitiv të publikut të huaj mbi të drejtën e vendit tonë për liri dhe pavarësi", tha kryetari i Kuvendit.

Ai përmendi me këtë rast botimin e shumë librave të autorëve të cilët edhe vetë ishin përfshirë në luftën për liri dhe pavarësi të Kosovës, si ish-presidentin amerikan Bill Clinton, ish-sekretaren e shtetit Madeleine Albright, ish-

kryeministrin e Britanisë së Madhe, Toni Blair, ish-kryeministrin e Italisë, Massimo D'Alema, ish-ministrin e Punëve të Jashtme të Gjermanisë, Joshka Fischer, ish-komandantin e NATO-s, Wesley Clark e shumë figura të njohura ndërkombëtare, në librat e të cilëve, siç tha kryetari Konjufca, çështja e Kosovës zë një kapitull të veçantë dhe mbetet si një trashëgimi në kujtesën historike në shoqërinë e tyre. "Këto biografi e libra analizash të periudhave kur ata vepruan mbesin edhe si një argument që do t'u shërbejë pasardhësve të tyre për të mos harruar politikën e drejtë që ata ndoqën në përkrahje të çlirimit dhe të pavarësisë së Kosovës", tha kryetari Konjufca.

Me këtë rast kryetari i Kuvendit përgëzoi AShAK-un për ekspozitën me botimet e librave të këtyre miqve që, siç tha ai, është jo vetëm shenjë mirënjohje ndaj tyre, por edhe kujtesë se sa e rëndësishme është të triumfojë e vërteta përballë propagandës, si një kusht esencial për paqe në botë.

Haradinaj dhe Latifi nderojnë 5 dëshmorët dhe 49 martirët e fshatit Brestoc



RAHOVEC, 25 MARS - Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj dhe kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, kanë përkujtuar në 25-vjetorin e përjetësimit të 49 martirët e Brestocit të vrarë nga pushtuesi serb. "Së bashku me kryetarin e AAK-së, z. Ramush Haradinaj dhe me bashkëpunëtorë nderuam 49 martirët e fshatit Brestoc, të vrarë në vitin 1999 nga pushtuesi serb, 5 dëshmorët dhe 6 të pagjeturit. Lufta jonë për liri nuk ka pushuar asnjëherë, sepse pushtuesit e kanë zëvendësuar njëri-tjetrin

dhe secili ka qenë më i egër se tjetri. Këtë egërsi e pagoi shtrenjtë edhe Brestoci, fshat që ka numër të madh të të martirizuarve, por nga ky fshat kanë dalë edhe shumë luftëtarë e veprimtarë, të cilët e kanë nderuar emrin e tyre dhe të vendlindjes. Po ashtu, në fushë të nderit kanë rënë 5 dëshmorë, lavdia e të cilëve qëndron si fllad pranveror mbi këtë vend. Lavdi 5 dëshmorëve, 49 martirëve të Brestocit, në mesin e të cilëve edhe 6 personave të pagjetur!", ka shkruar Latifi në "Facebook".

Policia rajonale e Ferizajt javën e kaluar shqiptoi 1 153 gjoba

FERIZAJ, 25 MARS - Policia Rajonale e Ferizajt ka ndërmarrë një sërë aktivitete për identifikimin e kundërvajtësve të ndryshëm në komunikacion me qëllim të parandalimit të aksidenteve.

Në kuadër të këtyre aktiviteteve Policia Rajonale e Ferizajt gjatë javës që shkoi,

nga data 18-24/03/2024, ka shqiptuar 1 153 gjoba kundërvajtëse, ndërsa ka hequr edhe 15 patentëshoferë për drejtuesit që kanë shkaktuar kundërvajtje më të rënda në komunikacion.

Ndërsa janë raportuar 39 aksidente, prej tyre: aksidente me lëndime, 17; persona të

lënduar, 21; aksidente me dëme materiale, 22.

Policia Rajonale e Ferizajt ka njoftuar se do të vazhdojë aktivitetet e shtuara, me synim parandalimin e aksidenteve në komunikacionin rrugor dhe u bënë thirrje shoferëve të bëjnë kujdes në komunikacionin rrugor.



Haradinaj: Absurde që sot po gjykohen çlirimtarët, ende s'është vendosur drejtësia mbi shumë masakra të kryera nga Serbia

PRISHTINË, 25 MARS - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka thënë se është absurde që sot në liri po gjykohen çlirimtarët, e ende nuk ka drejtësi për shumë masakra të kryera nga shteti fashist serb. Këtë deklaratë Haradinaj e ka dhënë të hënën në Fortesë dhe Brestoc të Rahovecit. "Fëmijë, gra e pleq

të pambrojtur u masakruan pa mëshirë para njëzetepesë vjetësh nga regjimi barbar i Millosheviqit. Sot, në nderim të Dëshmorëve dhe Martirëve të lirisë, bashkë me kryetarin e Rahovecit, Smajl Latifi, bashkëlufëtarë e kolegë, u bashkuam me familjet që i kujtuam me krenari më të dashurit e tyre; 75 të rënët në Celinë, 68 të rënët në Fortesë

dhe 54 të rënët në Brestoc. Është absurde që sot në liri po gjykohen çlirimtarët ndërsa ende nuk është vendosur drejtësia mbi shumë masakra të kryera nga shteti fashist serb, në civilë të pambrojtur. Sakrificat e tyre mbetet përgjithmonë në kujtesën tonë historike! Lavdi!", ka shkruar Haradinaj në "Facebook".



Abdixhiku nga Obiliqi godet Kurtin: Popullistët nuk e besojnë Kosovën, e shohin si të përkohshme



OBILIQ, 25 MARS - Kryetari i Lidhjes Demokratik të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, ka qëndruar të hënën në Obiliq, ku ka shënuar 34-vjetorin e themelimit të Degës së LDK-së në këtë komunë.

Abdixhiku ka thënë se LDK-ja po mbledh rreth vetes njerëzit më të mirë të vendit, si thirrje për ngritje të djathtë gjithnacionale, si domosdoshmëri për t'i dhënë vendit të ardhme.

Ai ka shtuar se Kosova është shumë e pasur për të qenë kaq e zymtë. "Kosova është shumë e pasur për të qenë e fundit në Evropë. Për të qenë kaq e zbrazët e për të qenë kaq e zymtë. Kosova ka plot njerëz punëtorë, familje të ndershme, biznese të shëndosha, mësues me ideale, mjek me pasion, shërbyes me

dinjitet. Kosova ka tradita të pasura që duhet t'i kultivojë me fanatizëm, e ka potenciale të jashtëzakonshme që duhet t'i shfrytëzojë me plot përkushtim", ka deklaruar Abdixhiku.

Ai ka thënë se popullistët nuk e besojnë Kosovën, e shohin si të përkohshme. "Popullistët këtë nuk kanë bregë. Fillimisht sepse nuk e besojnë Kosovën, e shohin si të përkohshme; e më pas sepse kanë tjetër synim. Ata bregë kanë mirëmbajtjen e vetes. Sa vota sjell një vendim. Dhe në këtë mirëmbajtje kanë mbetur të kurthuar në përballjen me të shkuarën. Aty qëndrojnë me mburrje e krenari, por aty Kosova s'duron të qëndrojë më", ka thënë lideri i LDK-së, Lumir Abdixhiku.

Të enjten Kuvendi mban seancë të jashtëzakonshme për kontratat njëburimore

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 25 MARS - Shefi i grupit parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, Abelard Tahiri, ka njoftuar se ka dorëzuar kërkesë për seancë të jashtëzakonshme për themelimin e komisionit hetimor parlamentar për kontratat njëburimore. "Sot dorëzoja kërkesën për seancë të jashtëzakonshme në emër të 40 deputetëve të Kuvendit për të enjten e kësaj jave. Kjo seancë do të shqyrtojë propozimin për

themelimin e komisionit hetimor parlamentar për kontratat njëburimore që grupi ynë parlamentar e ka parashtruar të premten e javës së shkuar", ka shkruar Tahiri në "Facebook".

Ai ka thënë se pushteti i Albin Kurtit vetëm në shtatë institucione ka keqpërdorur mbi 150 milionë euro taksa të qytetarëve përmes kontratave njëburimore që janë burim i korrupsionit. "Ky skandal duhet dhe do të hetohet deri në fund. Jo vetëm këto kontrata por edhe miliona eurot e tjera, shpenzimi i



të cilave është bërë në mënyrë të kundërligjshme. Shumica parlamentare e ka mundësinë që të votojë këtë komision e të dëshmojë vullnetin për t'u bashkuar në kërkesën për llogaridhënie që duhet ta ushtrojë Kuvendi. Në të kundërtën, çdo tentim për bllokim ose refuzim të themelimit të këtij komisioni është dëshmi e qartë e panikut dhe frikës për t'u ballafaquar me faktet dhe të vërtetën e cila herët ose vonë do të triumfojë. Hetimi do të ndodhë patjetër!", ka thënë Tahiri.

Aksion ndaj taksive ilegale në Prishtinë, inspektorati zotohet se nuk do ta tolerojë veprimtarinë e tyre

PRISHTINË, 25 MARS - Taksitë ilegale kanë qenë të hënën cak i Inspektoratit të komunës së Prishtinës dhe Policisë së Kosovës. Në një njoftim nga Inspektorati i Prishtinës është bërë me dije se nuk do të lejohen më që taksitë ta ushtrojnë veprimtarinë e tyre pa leje të

organit kompetentë. "Aksion i përgjithshëm i Inspektoratit të Kryeqytetit bashkë me Policinë në kryeqytet kundër transportuesve ilegal të udhëtarëve. Nuk do të tolerohen më tutje që këtë veprimtari ta ushtrojnë pa leje të organit kompetent të kryeqytetit duke

shkaktuar, përveç tjerash, edhe kaos të përgjithshëm në rrjedhën e komunikacionit në Prishtinë", thuhet në njoftimin për medie.

Inspektorati ka postuar disa fotografi në faqen në "Facebook", ku shihet se disa prej taksive u janë konfiskuar targat.



Besnik Tahiri: Kurti duhet të tregojë pse janë shpenzuar 209 milionë euro me tenderë njëburimorë?

PRISHTINË, 25 MARS - Shefi i grupit parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Besnik Tahiri, ka thënë se për këtë parti është e rëndësishme të trajtohet sa më shpejt kërkesa për debat parlamentar në trevjetorin e qeverisë Kurti. "Çështja kryesore e ballafaqimit të Kuvendit të Kosovës me qeverinë është llogaridhënia për tri vjet keqqeverisje dhe mospunë. Duhet të tregojë pse nuk janë shpenzuar 1 miliard e 225 milionë euro? Pse janë shpenzuar 209 milionë euro me tenderë njëburimorë? Pse nuk u rritën pagat në sektorin publik? Pse nuk ndodhi Ligi për Sigurimet Shëndetësore? Do ta dekodojmë/dekonspirojmë qeverisjen më të dobët në histori të Kosovës. Ky dekonspirim vjen duke u ballafaquar. Kur kam kërkuar rritje të pagave në



sektorin publik, kryeministri ka vendosur parametra të tjerë: është marrë me veriun e Kosovës, me problemin me tabela, me problemin e dinarit. Pra, nuk

kemi mundur të diskutojmë për politika publike. Për tri vjet jemi ekspozuar vetëm me kriza, në një situatë që kemi menduar se jemi në luftë", ka thënë Tahiri në një

deklarim për medie të hënën. Ai ka thënë se elementin më të rëndësishëm e ka pasur aspektin korruptim, por që nuk ka dashur ta diskutojë. "Kemi problemin

me rezervat shtetërore, që është në hetim. Problemin me energjinë elektrike me ambasadorin në Kroaci. Problemi me 209 euro përmes tenderëve njëburimorë", ka thënë ai. Sa i përket çështjes së dinarit, Tahiri ka theksuar se një çështje e brendshme të cilën e rregullon një institucion shtetëror kushtetues siç është BQK-ja, na është kthyer në një problem politik madhor që e ka diskutuar edhe Këshilli i Sigurimit i OKB-së. "Këto arsye i di vetëm kryeministri Kurti. Unë po e shoh dëmin që po i shkaktohet Kosovës me këtë temë. Ne vend se të fokusohemi në një agjendë ndërkombëtare, ku duhet të na ndihmojë faktori ndërkombëtar, jemi duke u marrë me çështjen e dinarit, që është totalisht çështje e brendshme e cila zgjidhet lehtë", ka thënë Tahiri.

Peci paralajmëron fermerët: Çdo deklaram i rrejshëm do të ketë pasoja ligjore

Prishtinë, 25 mars - Ministri i Bujqësisë, Faton Peci, i ka paralajmëruar fermerët se do të kenë pasoja ligjore për deklaramet e rrejshme për subvencione. Peci në "Facebook" ka bërë me dije se nga kontrollet e ushtruara vitin e kaluar në masën 100 % në shtatë komuna të Kosovës, kanë arritur të parandalojmë mashtrime me deklarime që kapin shumën afro 2 milionë euro. "Më shumë se paralajmërim është lutja ime për ju që të jeni korrekt në procesin e aplikimit pasi edhe këtë vit

Ministria do të ushtrorë kontrole strikte dhe nuk do të tolerojmë mashtrime me deklarime të rrejshme. Çdo deklaram i rrejshëm që haset, ka pasoja ligjore për ata që zihen duke bërë një gjë të tillë", ka deklaruar Peci. Ministri i Bujqësisë ka shtuar se duhet të tregojnë përkushtimin me ndershmëri dhe integritet në këtë proces. "Së bashku, le të mbjellim farën e besimit dhe transparencës ndërsa kultivojmë një të ardhme të begatë për bujqësinë e Kosovës", ka thënë ministri Peci.



Hovenieri takon drejtuesit e Odës Ekonomike në Kosovë dhe Serbi, flasin për përmirësim të bashkëpunimit

PRISHTINË, 25 MARS - Ambasadori amerikan në Prishtinë, Jeff Hovenier, ka takuar përfaqësuesit e Odës Ekonomike të Kosovës, Lulëzim Rafuna dhe atë të Odës Ekonomike të Serbisë, Marko Çadez. Në "X", Hovenieri ka

shkruar se kanë diskutuar për mënyrat e përmirësimit të bashkëpunimit ndërmjet komuniteteve. "Bisedë e mirë me drejtuesit e Odës Ekonomike të Kosovës dhe Odës Ekonomike të Serbisë mbi mënyrat për ta përmirësuar

bashkëpunimin ndërmjet komuniteteve të biznesit kosovar dhe serb në Kosovë dhe Serbi. Normalizimi i marrëdhënieve mes dy vendeve do të rrisë stabilitetin dhe prosperitetin rajonal", ka shkruar Hovenieri.



Nënshkruhen kontratat për ndërtimin e rrugës Kijevë - Dollc, brenda një jave nisin punimet

PRISHTINË, 25 MARS - Të hënën janë nënshkruar kontratat për ndërtimin e rrugës Prishtinë - Pejë, përkatësisht segmentin Kijevë - Dollc (lloset 2, 3 dhe 4), ndërsa lloset 1 është në rivlerësim. Lajmin e ka bërë me dije zëvendësministri i Mjedisit, Planifikimit

dhe Hapësinor dhe Hysen Durmishi. Durmishi në rrjetin social në "Facebook" ka shkruar se vlera e këtyre kontratave është 21 milionë euro. "Shpronësimet për këtë rrugë i kemi përfunduar të gjitha dhe kemi

kontraktuar mbikëqyrjen e jashtme profesionale që do të kujdeset për mbarëvajtjen e punimeve. Të gjitha përgatitjet janë bërë që brenda një jave të fillojnë punimet dhe që të mos ketë asnjë problem gjatë ekzekutimit të punëve në rrugë", ka shkruar Durmishi.



DOKUMENTE BRITANIKE PER DEMONSTRAT E VITIT 1981 NË KOSOVË (10)



Prof. dr. Sabit SYLA & Prof. dr. Hamit KABA

-34-

Konfidenciale

GRS 320
Kopje origjinale
Fm Beograd 181400Z, maj '81
Drejtuar direkt FCO
Tel. nr. 69, i datës 18 maj '81
ENU 015/3
Deskby 191000Z
RFI UKDEL, NATO, MODUK
Ruhet për Washington
Telegrami im, nr. 66

Kosova

1. Që prej publikimit të konkluzioneve të mbledhjes së Komitetit Qendror, më 14 maj, Lidhja e Komunistëve ka zhvilluar një fushatë të fuqishme në Kosovë për të spastruar radhët e saj nga të gjithë ata elementë të cilët ose morën pjesë në demonstrata ose u simpatizuan me to. Rreth 200 anëtarë partie janë përjashtuar deri më sot dhe të tjerë janë pushuar nga Universiteti i Prishtinës, disa shkolla të mesme, shtëpia botuese e gazetës kryesore, televizioni dhe radioja si dhe institucione të ndryshme kulturore. Asnjë figurë tjetër politike drejtuese nuk ka dhënë dorëheqjen, megjithëse disa janë kritikuar publikisht ose kanë bërë autokritikë publikisht. Anëtarët e Partisë në Universitet po tregohen të ngadaltë për të shprehur pozicionin e tyre. Është shpallur gjykimi për disa shqiptarë në Maqedoni të akuzuar për organizimin e aktiviteteve politike armiqësore atje.

2. Shtypi vazhdon të përshkruajë situatën e përgjithshme politike të sigurisë si shumë të vështirë, por gjatë ditëve të fundit nuk janë raportuar incidente. Nga Tirana pretendohet se një aksion i milicisë më 13 maj, kundër një shqiptari vendas të kërkuar për krime të ndryshme që nuk kanë lidhje me ngjarjet e fundit, i cili rezultoi me katër milicë të vrarë dhe tre të plagosur përveç personit të kërkuar dhe babait të tij që u vranë, ka qenë një sulm nga "milicia ndëshkuese serbe" ndaj një fshati të pafajshëm shqiptar.

3. Më 14 maj, ambasadori shqiptar këtu është thirrur pranë Sekretariatit për Punët e Jashtme për t'i paraqitur një protestë të fortë për "ndërhyrje të ashpër" nga ana e Shqipërisë në punët e brendshme të Jugosllavisë. Më vonë ai u kritikua personalisht nga zëdhënësi zyrtar për rolin e tij dhe të Ambasadës së tij. Gjer tani Plaka nuk është thirrur më, por zëdhënësi tha se qeveria shqiptare duhet ta marrë "seriozisht në konsideratë" këtë.

FCO ju lutemi të ruhet kopje për

Uashington
Bolland
[Përsëritet sipas kërkesës]

-35-

Konfidenciale

GRS 360 Kopje origjinale
Fm Beograd 201030Z, maj '81
Drejtuar direkt FCO
Telegram nr. 070, i datës 20 maj '81
Prioritet për UKDEL, NATO, MODUK
Dhe ruajtur për Washington
Telegrami im nr. 069

Kosova

1. Është njoftuar më 19 maj, se qeveria e Kosovës kishte vendosur të mbyllte menjëherë Universitetin e Prishtinës, konviktet e studentëve dhe mensat, d.m.th. para përfundimit të zakonshëm të semestrit. Kjo situatë vijoi me një vlerësim të komitetit lokal për mbrojtjen e të gjithë njerëzve dhe vetëmbrojtjen sociale se gjatë ditëve të fundit situata në universitet ishte bërë "e vështirë". Shtypi raportonte se gjatë dy netëve të mëparshme me qindra studentë ishin mbledhur në kampus dhe kishin kënduar këngë nacionaliste dhe kishin hedhur parulla armiqësore. Autoriteteve të Universitetit u ishte kërkuar që të shikojnë mundësinë për të zhvilluar provimet e rregullta në qershor.

2. Kjo masë e ngutshme nga autoritetet kosovare konfirmon se ata nuk janë në gjendje të kontrollojnë nacionalistët në Universitet dhe për rrjedhojë u është dashur të marrin këtë masë administrative për të shmangur çdo shqetësim të mëtejshëm. Me sa duket ata kanë supozuar se nacionalistët do të kontrollohen më lehtësisht në grupe të vogla në shtëpitë e tyre. Sidoqoftë, kjo mund të ketë edhe efektin e kundërt në përhapjen e trazirave.

3. Në konfirmim të telekonf. nga Clark/Gray, njoftoj se një zëvendëskryetar i Këshillit Ekzekutiv për Arsimin dhe Kulturën dhe sekretari për Arsimin dhe Kulturën dhanë dorëheqjen, më 18 maj. Në të njëjtën ditë filloi në Shkup gjykimi i pesë shqiptarëve vendas të akuzuar për aktivitet armiqësor në Maqedoni. Sipas deklaratave të këtyre të fundit, ata kanë marrë mbështetje nga Shqipëria.

4. Artikulli i gazetës "Zëri i Popullit" i datës 17 maj që bënte fjalë për statusin e Republikës së Kosovës është hedhur poshtë sot përmes një deklarate në "Tanjug" si një dëshmi tjetër e mbështetjes nga Tirana për kundërrevolucionarët në Kosovë. Megjithatë, kjo deklaratë nuk hyri në rastin historik të argumentuar me zgjuarsin nga Shqipëria për pavarësinë e Kosovës nga Serbia, përveç se përsëriti shpjegimet e aktit final të Helsinkit mbi nevojën për të respektuar pandryshueshmërinë e kufijve të trashëguar nga Lufta e Dytë Botërore.

Bolland

-36-

Sekret

GR 150
Fm FCO 211727Z, maj '81
Informacion rutinë për Moskën
Nr. i telegramit 311, datë 21 maj
Dhe për Beogradin

Kosova

1. Ambasadori jugosllav, Berisavljeviç, ka pretenduar në disa raste se në trazirat aktuale në Kosovë ka dorë sovjetikë dhe ka sugjeruar se arsyeja është për të diskretituar shembullin jugosllav në një kohë kur mund të bëhej gjithnjë e më tërheqës para syve të polakëve. Aktualisht ka të dhëna se ky qëndrim pasqyron drejtimin zyrtar jugosllav.

2. Duke shprehur mirënjohje për komentet tuaja mbi tezën e Berisavljeviç, natyrisht nuk dyshojmë se në aspektin afatgjatë rusët shpresojnë t'i kthejnë sërish jugosllavët në vathën e vet. Por, duhet të përhumbim vlerësimin tuaj se deri ku mund të shkojnë rusët qëllimisht për të destabilizuar Jugosllavinë, duke i nxitur ndoshta ne shpresën se do të përfitojnë nga rritja e tensionit midis Jugosllavisë dhe Shqipërisë, ose thjesht duke i vështiruar ngjarjet në distancë me shpresën se në fund të fundit ngjarjet do të kthehen në duart e tyre.

Carrington

Kopje për stafin e vlerësimit Zyra e Kabinetit
Ky dokument është kopje. Originali është ruajtur në Departament në Seksionin 3(4) të aktit të të dhënave publike, 1958.

-37-

Sekret

GR 150
Fm FCO 211727Z, maj '81
Informacion për Moskën
Telegram nr. 311, i datës 21 maj
Dhe për Beogradin

Kosova

1. Ambasadori jugosllav, Berisavljeviç, ka pretenduar në disa raste se ka vënë re dorën sovjetike në trazirat aktuale në Kosovë dhe ka sugjeruar se motivi është për të diskredituar shembullin jugosllav në një kohë kur mund të bëhej gjithnjë e më tërheqës për shembull, para syve të polakëve. Tashmë ka të dhëna se ky qëndrim pasqyron drejtimin zyrtar jugosllav.

2. Jemi mirënjohës për komentet në lidhje me sugjerimet e tezës së Berisavljeviç. Natyrisht që nuk dyshojmë se në aspektin afatgjatë, rusët me të vërtetë shpresojnë që t'i kthejnë jugosllavët sërish në vathë. Por, ne duhet të mirëpresim vlerësimin se deri ku mund të kërkojnë rusët qëllimisht të destabilizojnë Jugosllavinë, mbase duke shkakuar përçarje me shpresën se do të përfitojnë nga rritja e tensionit midis Jugosllavisë dhe Shqipërisë, apo thjesht duke i vëzhguar nga larg në pritje me

shpresën se në një periudhë afatgjatë ngjarjet do të kthehen në duart e tyre.

Carrington
Kopje për stafin e vlerësimit, Zyra e Kabinetit.
Ky dokument është kopje. Originali është ruajtur në Departament në Seksionin 3(4) të aktit të të dhënave publike 1958.

-38-

Konfidenciale

N H R A Broomfield ESQ
Ambasada britanike
EESD, Athinë
FCO, 26 maj 1981
I ndëruar Nigel,

Kosova

Më 20 maj diskutova me z. Mazarakis, drejtor i Drejtorisë së Ministrisë së Punëve të Jashtme, përgjegjës për marrëdhëniet me vendet komuniste, mbi pikëpamjen greke për zhvillimet në Kosovë.

2. Mazarakis u shpreh se grekët nuk ishin informuar aq sa do të donin për shkak të karantinës që jugosllavët kishin imponuar në këtë zonë. Konsulli grek në Shkup nuk ishte lejuar që të udhëtonte atje.

3. Megjithatë, ai kishte një pikëpamje të qartë mbi origjinën e këtyre trazirave. Kjo ishte një pikëpamje e zakonshme se trazirat filluan në Kosovë dhe nuk u nxitën nga ndonjë forcë e jashtme. Arsyeja për këtë ishte një kombinim i pakënaqësisë nacionaliste nga ana e banorëve myslimanë që ishin nën juridiksionin e Serbisë, me pakënaqësitë ekonomike. Mazarakis kujtoi një vërejtje profetike të bërë nga Dolanç 2 vjet më parë para ambasadorit grek me efektin se Jugosllavia do të përballej shpejt me probleme reale që do të lindnin nga ambicet konfliktuale të nacionalistëve, sidomos myslimanëve të Kosovës.

4. Mazarakis konstatoi se deklarata të ndryshme të politikanëve jugosllavë mbi origjinën e trazirave ishin konfuze dhe kontradiktore, dhe nuk gjenin asnjë kuptim në atë që Dolanç kishte thënë për përgjegjësinë e Kominternit dhe tendencave fashiste nga jashtë vendit. Greqia nuk kishte të dhëna për përfshirjen e Qeverisë shqiptare dhe të dhënat dukej se me të vërtetë ishin të kundërta, p.sh.: periudha 3-ditore e prapambetur para raportit të parë të trazirave të shprehura në gazetën "Zëri i Popullit", si dhe hendekun 7-ditor para artikullit të parë të rëndësishëm. Kjo situatë sugjeronte se shqiptarët ishin kapur në befasi. Gjithashtu, grekët nuk kishin asnjë të dhënë për përfshirjen apo nxitjen sovjetike dhe ishin të shqetësuar nga një artikull i Cyrus Sulzberger i botuar në "New York Times" (një kopje bashkangjitur) ku sugjerohej se Greqia kishte "informacion të saktë" se kryengritja e Kosovës ishte nxitur nga Moska. Mazarakis tha se Sulzberger nuk kishte kërkuar pikëpamjen e Ministrisë së Jashtme

greke, fakt për të cilin ai kishte kontrolluar pranë Ministrisë së Mbrojtjes, e cila mohoi të kishte informuar Sulzbergerun në këtë drejtim.

5. Mazarakis sugjeroi se jugosllavët kishin bërë gabim kur kishin lejuar që niveli i kontaktit midis Shqipërisë dhe myslimanëve të Kosovës të ishte kaq i rëndësishëm; ai iu referua lidhjeve arsimore dhe kulturore duke përfshirë vizitat e profesorëve shqiptarë në universitet. Një gjë e tillë thjesht kishte nxitur tendencat nacionaliste në radhët e myslimanëve. Vendimi i kohëve të fundit për të mbyllur universitetin ishte tregues i faktit që jugosllavët i njohën gabimet e tyre. Ai mendoi se në rrethanat aktuale do të ishte e pamundur për Qeverinë Socialiste Federative të Jugosllavisë që t'i jepte Kosovës statusin e Republikës. Kjo do të ishte një tronditje e fortë për krenarinë serbe dhe në çdo rast do të ishte e pamundur që të gjendej konsensusi i nevojshëm në udhëheqjen jugosllave për këtë kurs veprimesh. Mazarakis bëri të qartë se meqenëse sipas pikëpamjes greke praktikisht çdo ndryshim kushtetues, përfshirë lëshimet ndaj Kosovës, mund të ishte destabilizues, ai mendoi se Qeveria Socialiste Federative kishte të drejtë të mos bënte lëshime - një pikëpamje që padryshim ngrre pyetjen e pasojave të mundshme destabilizuese të mungesës së fleksibilitetit.

I Juaji,
M. J. Llewellyn Smith
Për dijeni: Kancelarive, Beograd-Moskë.

-39-

International Herald Tribune

By C.L. Sulzberger

Balkan questions

Athinë - Situata strategjike në Ballkan ka ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme muajt e fundit. Greqia ka "informacion të saktë" se revolta e pakicës shqiptare të Jugosllavisë në zonën e Kosovës është stimuluar nga Moska dhe ishte shumë më serioze sesa kuptohej në përgjithësi jashtë vendit. Parullat e përdorura ishin prosovjetike, jo pro Enver Hoxhës, kreut të Shqipërisë së pavarur. U deshën disa ditë që forcat e Beogradit të rivendosnin rendin. Konkluzioni i nxjerrë këtu është se Bashkimi Sovjetik po heton Jugosllavinë e pas epokës së Titos për të parë se çfarë mjetes mund të zbulojë në shpërbërjen e unitetit të saj nën sundimin e komitetit. Greqia është e detyruar të ndihmojë Jugosllavinë në fund të fundit përmes transportimit të armëve të SHBA-së në rast të ndonjë kërcënimi të drejtpërdrejtë sovjetik të fqinjit të saj verior. Kjo marrëveshje është negociuar me miratimin e SHBA-së kur Tito ishte ende gjallë, nga ministri jugosllav

dhe ai grek i mbrojtjes. Një tjetër pasojë e kësaj situatë të re - të paktën siç nënkuptohet nga trazirat në Kosovë - është që t'i kujtohen Greqisë detyrimet e saj në NATO dhe në të njëjtën kohë të zhvendosë vëmendjen e autoriteteve më të larta ushtarake nga frika e kërcënimit turk ndaj kufijve veriorë të Greqisë.

Ka edhe një shqetësim në atë që grekët e quajnë "Pentagoni" i tyre që Kremlini, me gjithë preokupimet e veta me Poloninë, mund të parashikojë testimin e zhvillimeve të ngjashme me Kosovën në Maqedoninë e Jugosllavisë ku ekziston elementi probullgar. Bullgaria është satelit i bindur i Moskës.

Një tjetër pikë e lidhur në mënyrë indirekte me shqetësimin e ringjallur për mikun e Greqisë, Jugosllavinë, është ulja graduale e tensionit midis këtij vendi dhe Turqisë. Ndërmjet këtyre dy vendeve të NATO-s ka ekzistuar një krizë serioze që prej pushtimit turk të Qipros në vitin 1974. Me gjithë një alarmim të vogël këtë muaj kur 11 aeroplanë luftarakë turk vërshuan mbi ishullin grek të Kios dhe ujërat territoriale dhe turqit kërkuan falje për këtë "gabim", duket se Qetësia u rikthye.

Autoritetet e larta, ndërkohë që nuk e pëlqenin idenë e një qeverie ushtarake si në Ankara, pranojnë se junta ushtarake e ka shpëtuar Turqinë nga një kërcënim i pashmangshëm dhe luftë të mundshme civile.

Që prej asaj kohe negociatat midis Athinës dhe Uashingtonit janë zhvendosur paksa në kërkimin për një marrëveshje bilaterale për të vendosur një bazë të SHBA-së këtu. Kjo kërkësi duhet të arrijë një pikë vendimtare kur sekretari i Shtetit, Alexander M. Haig Jr., të takojë ministrin e Jashtëm grek në Romë në fillim të muajit tjetër.

Të dyja vendet e pranojnë nevojën për një marrëveshje të re me shkrim por ka pasur vonesa në drejtim të arritjes së një marrëveshjeje të tillë. Qeveria greke fajëson Uashingtonin që nuk ka përshpejtuar bisedimet para se parlamenti i Athinës të shpërndahet brenda dy muajsh për të vijuar me zgjedhjet e reja. Parlamenti i ri i cili sipas Kushtetutës do të nevojitet të ratifikojë ndonjë marrëveshje bilaterale, pa dyshim që do të jetë më i majtë dhe më pak i prirur për të pranuar një marrëveshjeje të re me Shtetet e Bashkuara.

Greqia dëshiron që marrëveshja e propozuar për bazën ushtarake të formulohet saktësisht si marrëveshjet midis SHBA-së dhe Turqisë për bazat ushtarake, por Uashingtoni ka kundërshtuar ndryshimin e gjuhës së drafteve të sugjeruara. Gjithashtu, Shtetet e Bashkuara kundërshtojnë që të nënshkruajnë një angazhim me shkrim sipas të cilit Greqisë do t'i jepet e drejta të blejë pajisje ushtarake të Shteteve të Bashkuara në një raport armësh prej shtatë të tilla për Greqinë në dhjetë të tilla për Turqinë.

Një raport i tillë është rënë dakord në një dokument të firmosur nga ministri i Jashtëm dhe sekretari i Shtetit, Henry Kissinger, në vitin 1976 nën drejtimin e administratës Republikane të SHBA-së. Megjithatë, ky dokument nuk është

ratifikuar nga parlamenti grek apo Kongresi i SHBA-së dhe ka mbetur një letër e vdekur.

Uashingtoni ishte përgatitur gjithashtu të garantonte një kundërpërgjigje "të menjëhershme" ndaj çdo lëvizjeje të re ushtarake në zonën e Egjeut, nëse Greqia do të kërkonte të çmilitarizonte ishujt e saj afër Turqisë. Greqia konsideroi se një garanci e tillë kishte thjesht vlerë "teorike". Nën administrimin e Carter, një zyrtar i lartë nënkuptonte se marrëveshja me Greqinë ishte pikëpamje skeptike.

Mbroni krahët Ndërkohë, situatë strategjike e Turqisë ka ndryshuar. Revolucioni gllabëroi Iranin fqinj. Qeveria turke është e shqetësuar gjithashtu për situatën në Irak dhe Siri. Personalisht, udhëheqësit grekë besojnë se Shtetet e Bashkuara e kundërshtojnë raportin 7 me 10 të armëve pasi mund të dëshirojnë të bëjnë edhe më shumë ndarje bujare të disponueshme për Turqinë për shkak të shtimit të shqetësimeve gjeografike të Ankarasë në Lindjen e Mesme.

Këtyre komplikimeve, çdokush shton edhe shqetësimin në rritje për të ardhmen e Jugosllavisë simbolizuar në çështjen e Kosovës. Rezultati i dukshëm është - ose duhet të jetë - rritja e presionit të ngjarjeve për z. Haig dhe ministrin e Jashtëm grek për të qetësuar njëri-tjetrin përmes koncensioneve në Romë muajin e ardhshëm për të siguruar aftësinë e vazhdueshme të SHBA-së për të ndihmuar në mbrojtjen e krahut lindor të Aleancës.

Një gjë e tillë do të përmirësonte shanset për të bërë hapa në drejtim të rikthimit të miqësisë greko-turke. Bllokimet e vazhdueshme diplomatike ndërmjet Uashingtonit dhe Athinës si dhe ndërmjet Athinës dhe Ankarasë mund të jenë fatale.

-40- Sekret

GR 200
Fm Moskë 261155z, maj '81
Informacion rutinë për FCO
Nr. i telegramit 295, datë 26 maj
Informacion për Beogradin
Telegrami juaj nr. 311

Kosova

1. Mendoj se rusët thjesht po vëzhgojnë situatën në distancë. Vlerësimi ynë vazhdon të jetë se në aspektin afatgjatë interesi sovjetik është që të ruajë marrëdhënie korrekte me Jugosllavinë, së paku deri kur mosmarrëveshjet të fillojnë të shfaqen në radhët e udhëheqjes jugosllave mbi mënyrën se si do të përballojnë problemet e vendit. Raportimi i shtypit sovjetik mbi Kosovën ka qenë i shkurtër dhe komenti i vetëm ishte që të mohonte (gazeta "Pravda" e datës 19 prill: letra e znj. Jackson e datës 21 prill drejtuar Manning) pretendimet për ndërhyrje sovjetike, gjë që në fakt i irritoi rusët. 2. Ambasada jugosllave këtu nuk ka shkuar më tej sesa të shprehet se rusët nuk janë "të pakënaqur" për trazirat në Kosovë. Nuk kemi të dhëna që tregojnë se shembulli jugosllav po bëhet "gjithnjë e më tërheqës" në Evropën Lindore apo se Bashkimi Sovjetik është i

përfshirë në këtë rezultat. Dyshoj se situata është krejt e kundërta - shoqata "Solidariteti" është ndoshta shumë më e pavarur se sindikatat jugosllave. Mbase një ditë këto të fundit do të mësojnë prej eksperiencës së shoqatës "Solidariteti".

Brooke Turner

[Ky telegram nuk është përcjellë]

-41- Konfidenciale

A. E. Montgomery Esq
Ambasada britanike
Beograd
27 maj 1981
Departamenti Sovjetik dhe i Evropës Lindore
Zyra e Jashtëm dhe e Komonuelthit Inderuar Alan,

Kosova: situata e brendshme politike

1. Komiteti Krahinor i Lidhjes së Komunistëve të Kosovës u mbledh në Prishtinë më 23 maj nën drejtimin e kryetarit të ri, Veli Deva. Shtypi u tregua i kujdesshëm për të njoftuar se mbledhja është ndjekur nga anëtarë të organizatave federale dhe serbe, të zgjedhura nga Kosova, dhe një përfaqësues zyrtar i Komitetit Qendror Serb. Pra, nuk mund të ketë justifikime të tjera për njerëzit në qendër që të mos e dinin se çfarë po ndodhte në Kosovë, si dhe theksimin e sovranitetit të Serbisë.

2. Objekti i mbledhjes ishte që të diskutohet një program veprimi me objektivin për të përshpejtuar eliminimin e shkaqeve të trazirave të kohëve të fundit. Hyrja u bë nga Mustafa Pljakić, anëtar i Kryesisë së Lidhjes së Komunistëve të Kosovës. Ai tha se programi duhej të ishte si vetëkritik për Lidhjen e Komunistëve për të çrrënjësuar dobësitë e veta, ashtu edhe fuqimisht kundërsulmues. Nuk është e vështirë që nga ky përshkrim të nxjerrim përfundimin se programi i veprimit i cili është në zhvillim e sipër prej disa javësh, nuk po shkon aq mirë sa pritej. Me të vërtetë, Pljakić tha se "armiku" ishte ende aktiv dhe se situata politike e veçanërisht në ato vende ku nuk kishte pasur asnjë të tillë deri më sot. Programi aktual pretendohej që do

të sillte disa rezultate, por në të njëjtën kohë ky program ishte plot me "mosmarrëveshje, pasivitet dhe oportunitizëm".

3. Pljakić tërhoqi vëmendjen veçanërisht në dobësitë "e panumërta dhe serioze" në zbatimin nga ana e LK të politikës për marrëdhënie në nivel komunal në Kosovë. Duhej përcaktuar vija e qartë midis afirmimit kombëtar të shqiptarëve të Kosovës dhe nacionalizmit dhe irredentizmit të Shqipërisë, si dhe patriotizmit jugosllav që nevojitet të inkurajohej. Në këtë kontekst, ai theksoi nevojën për të analizuar dhe vlerësuar shkaqet e migracionit të serbëve dhe malazezëve nga Kosova.

4. Pljakić dha më pas një përshkrim të programit të ri të veprimit, i cili fillonte me marrëdhëniet me Shqipërinë. Pljakić u shpreh se një nga burimet kryesore të indoktrinimit ideologjik në nacionalizmin dhe irredentizmin shqiptar ishte "propaganda intensive, e vazhdueshme, armiqësore dhe subversive nga Shqipëria". Diku tjetër, ai e përshkroi këtë propagandë si "brutale, të organizuar dhe antijugosllave". Tashmë ishte e nevojshme për të gjithë të interesuarit në Kosovë që të rishikonin në mënyrë kritike bashkëpunimin aktual me Shqipërinë, veçanërisht të gjitha marrëveshjet në fushën e arsimit, shkencës, kulturës dhe turizmit. Shtypi më pas e citoi Pljakićin fjalë për fjalë, si për të theksuar rëndësinë: "Të gjitha kontaktet dhe marrëdhëniet e mëtejshme midis Kosovës dhe Shqipërisë duhet të zhvillohen në kuadrin e marrëdhënieve ndërkombëtare të përcaktuara midis Jugosllavisë dhe Shqipërisë mbi parimet e politikës sonë të jashtëme". Kështu, është e qartë që nuk do të ketë më privilegj të praktikës së kaluar të Kosovës për të lidhur marrëveshje bilaterale me Shqipërinë pak a shumë pa dijeninë e Beogradit.

5. Pljakić trajtoi më pas nevojën për një analizë kritike të zhvillimeve intensive aktuale të arsimit të përgjithshëm në Kosovë. Duke filluar në krye me Universitetin e Prishtinës, Pljakić foli për pakujdesitë dhe dobësitë e politikës personale dhe theksoi se ishte e nevojshme që të thellohej spastrimi i stafit dhe të përjashtoheshin të gjithë ata që nuk kishin cilësitë e duhura morale, politike dhe akademike dhe që ishin të mbushur me qëndrime nacionaliste, irredentiste dhe të tjera armiqësore.

Programi mësimor dhe tekstet shkollore duhej gjithashtu të çliroheshin nga i ashtë-quajtur "romanticizëm" dhe çdo gjë tjetër që sillte vetëdije nacionaliste dhe irredentiste.

6. Duke iu kthyer kulturës, Pljakić bëri thirrje për një vlerësim kritik të programeve të institucioneve kulturore, repertorëve teatralë, filmave, dhe veçanërisht, programeve të shoqërive kulturore/artistike, të cilat duhet të spastrohen nga i tërë glorifikimi i trashëgimisë kulturore, krenaria kombëtare, përjashtimësia dhe nacionalizmi. Kjo është pa dyshim e nevojshme në dritën e përvojës por do të ketë implikime të rëndësishme nëse ndiqet në mënyrë të vazhdueshme për politikën e Jugosllavisë në drejtim të nxitjes së zhvillimit të lirë të pakicave kombëtare dhe të drejtës së tyre për të gëzuar trashëgiminë e tyre kulturore dhe gjuhësore.

7. Pljakić iu kthye më pas çështjes së medias dhe i bëri thirrje komunistëve që të rishqyrtonin në mënyrë kritike politikën editoriale dhe konceptet e medias në të cilën punojnë.

8. Në përfundim, Pljakić foli për problemet që lidhen me Kushtetutën dhe detyrat e përfshira në Planin aktual 5-vjeçar, i cili do të kërkonte, dhe përsëri këtu fjala e tij u citua tekstualisht: "harmonizimin e pikëpamjeve ndërmjet Krahinës, Republikës dhe Federatës".

9. Mbetet për t'u parë nëse autoritetet janë më të suksesshme, apo më të kujdesshme në zbatimin e këtij programi. Problemet e përfshira janë të konsiderueshme, veçanërisht në Universitetin e Prishtinës, i cili po del çdo ditë e më qartë se është drejtuar në vija që ishin ose politikisht naive ose qëllimisht subversive. Staf kryesues i mësimdhënies u akuzua nga Fadil Hoxha në fillim se ishin të vonuar në deklarimin e qëndrimit të tyre. Tani, dy muaj më vonë të trembëdhjetë komunistët në Akademinë e Arteve dhe Shkencës së Kosovës kanë deklaruar mbështetjen e tyre për qëndrimin zyrtar, por nuk ishin të matur sa duhet në kritikën ndaj shtypit për raportimin e tij të supozuar tendencioz mbi Universitetin. Ata kundërshtuan veçanërisht etiketimin e tij si "bastion i nacionalizmit". Që atëherë, Këshilli i Universitetit është mbledhur dhe, megjithëse ka pranuar dobësitë që armiku kishte shfrytëzuar, shumë anëtarët kanë kundërshtuar gjithashtu trajtimin e situatës nga ana e



medies. Siç e theksoi me forcë në refuzimin e tij të këtij kriticismi, shtypi kishte përdorur vetëm fjalë dhe informacion nga burime zyrtare (citimi i veçantë erdhi nga një anëtar i Komitetit Qendror të LKJ-së!). Shtypi, i nxitur nga disa politikanë, konkretisht Joze Smole i Komitetit Qendror të Sllovenisë, i cili tha në një intervistë së fundmi se duhet "të raportojë çdo gjë që sheh pa marrë parasysh nëse ndokush thotë se nuk është e lejuar", është në ditën e tij të dëfrimit, veçanërisht me argumentet sipërfaqësore të profesorëve të Universitetit për të justifikuar politikën e tyre në drejtim të angazhimit të stafit nga Tirana.

10. Por, edhe Universiteti po përkulet përpara presionit politik, jo pa mëri, dhe Këshilli i tij po shqyrton me autoritetet e arsimit një sërë masash që synojnë pakësimin e futjes së studentëve vitin e ardhshëm në përgjithësi dhe në veçanti jashtë Kosovës, duke i drejtuar ata në degë studimi që kanë kërkesë më të madhe në industri, duke i shpërndarë disa fakultete dhe shkolla në qytete të tjera dhe duke reduktuar publikimin, duke lidhur stafin mësimdhënës dhe gjuhët më afër me përbërjen e organizatës studentore (4 shqiptarë me 1 folës serbo-kroat në vend të raportit aktual 3 me 1); e gjithë kjo me qëllim uljen e presionit për Prishtinën.

11. Jashtë Universitetit ka raporte që flasin për rezistencë ndaj spastrimeve në organizata të ndryshme, veçanërisht në disa nga shkollat e mesme dhe fabrika, ku pas dy muajsh njerëzit ende refuzojnë të deklarojnë nëse kanë marrë pjesë në demonstrata apo nëse kanë dhënë ndonjë mbështetje tjetër.

12. Ka probleme të tjera për vetë udhëheqjen, jo vetëm në Kosovë por edhe më gjerë. Gazeta "NIN" e kësaj jave kishte një kryeartikull të thekshëm kritik, i cili akuzonte udhëheqjen e Kosovës së pari se i kishte hedhur hi syve gjithsecilit për gjendjen e vërtetë aktuale aty, kështu që ata i kërkonin shkaqet në vendin e gabuar, dhe së dyti se ishte përpjekje për t'i fshehur ato. Siç tha gazeta "NIN": "Për disa qarqe në Kosovë, identifikimi i të cilave është në proces, duket se ishte me rëndësi jetësore që analiza të drejtohej në rrugën e gabuar në vend që të kërkohej burimet e ngjarjeve të fundit ku ishte e nevojshme dhe ku po kërkohen". Gazeta "NIN" besonte se burimet shtriheshin në të kaluarën dhe se Kosova tani po korrte çfarë kishte mbjellë më parë, d.m.th., për vite njerëzit kishin pëshpëritur për krijimin e një "Kosove etnikisht të pastër", për raste të shumta të tolerancës së sulmeve mbi joshqiptarët, dokumentimin e migrimit të këtyre të fundit nga Kosova, nacionalizmin në politikën kulturore, etj. Gazeta "NIN" pyeti: "Në çfarë shkalle njerëzit të caktuar me emra, mbiemra, funksione të caktuara e dinë këtë dhe, nëse nuk e kanë mbështetur, të paktën e kanë toleruar dhe kanë heshtur"? Gazeta "NIN" besonte se akuzat duhej të bëheshin ndaj atyre që janë përgjegjës, përndryshe kishte rrezik që të fajsohej grupet në vend të individëve dhe të përhapeshin forma të tjera nacionalizmi.

13. Kjo temë është trajtuar në nivel



federal në një diskutim për Kosovën, më 25 maj, në Komitetin Socio-Politik të Kuvendit Federal. Një deputet tha se një pjesë e madhe e përgjegjësisë duhet të bjerë mbi udhëheqjen e Kosovës dhe se nuk mund të ketë progres deri kur kjo të sqarohet. Në të njëjtën kohë ai tha se duhet të ngrihet çështja për përgjegjësinë e organeve të caktuara të Federatës për mosnjohje ose keqvlërim të fenomeneve të ndryshme dhe për fshetje të tyre për arsye të ndjeshmërisë kombëtare. Një tjetër deputet trajtoi të njëjtën çështje dhe shtoi se deri së fundmi thuhej në mënyrë të vazhdueshme se situata e sigurisë ishte e mirë. Kjo nënkuptonte, tha ai, se duhej shqyrtuar puna e organeve federale përgjegjëse. Në intervistën e tij, Joze Smole përsëriti gjithashtu kërkesën e tij të bërë në mbledhjen e fundit të Komitetit Qendror që të botohej rezultati i vizitës së Karkeljt në Kosovë, në vitin 1977. Me sa duket Karkelji e pa se çfarë po ndodhte dhe bëri rekomandime të ndryshme të cilat duket se nuk u ndoqën. Smole dhe të tjerë duan të dinë se pse këto rekomandime nuk u ndoqën.

14. Deri tani nuk kam parë asnjë tregues të ndonjë dorëheqjeje tjetër por gjithsesi, në këtë periudhë të vitit shumë njerëz që mund të kenë qenë të implikuar po qarkullojnë në vendet e punës. Kështu, Dragosavac, sekretari i Kryesisë së Lidhjes së Komunistëve, është zëvendësuar nga Culafiç në fund të mandatit të tij dy-vjeçar. Në Kosovë, Azem Vllasi (shqiptar me bashkëshorte kroate dhe gjithnjë në rritje) u emërua Kryetar i Lidhjes Socialiste aty për një periudhë një-vjeçare. Por, siç raportova javën e kaluar, sekretari federal i Punëve të Brendshme është ende në vendin e tij, po ashtu si sekretarët e Zyrës së Informacionit këtu dhe në Kosovë si dhe rektori dhe stafi drejtues i Universitetit të Prishtinës. Njerëz të ndryshëm më kanë thënë se do të ketë më shumë dorëheqje, por ndërkohë, siç ka sugjeruar gazeta "NIN", njerëzit bëjnë pyetje. Kredibiliteti i politikanëve është shtrirë më tej përmes një filmi në TV ku flitet për një mbledhje të Kryesisë së Kosovës që tregon Bakallin i cili bie

shumë në sy në tryezën e diskutimit!

15. Në këtë mënyrë, situata mbetet e paqëndrueshme dhe shumica e kontakteve tona janë të errëta për të pasur ndonjë përmirësim të hershëm. Por të paktën, gjithnjë e më shumë kjo situatë po bëhet e njohur publikisht, gjë që në vetvete, është e shëndetshme dhe e jashtëzakonshme. Gjithashtu, janë mbledhur të dhëna që flasin për një kontroll më të rreptë si nga Federata dhe Serbia në Krahinën e pabindur. Megjithatë, është ende shumë herët për të parashikuar rezultatin.

I Juaji,
T. J. Clark
Për dajeni: P. Rosling Esq
Zagreb
P. Rennie Esq
Departamenti i Kërkimit

-42-
Sekret

Fm Beograd 270720z, maj '81
Informacion rutinë për FCO
Telegrami nr. 074, 27 maj '81
RFI Moskë
1 qershor 1981
Telegrami juaj nr. 311

Kosova

1. Nuk ka shenja këtu që të flasin për ndonjë ndryshim thelbësor të politikës sovjetike të periudhës post-Tito në drejtim të Jugosllavisë. Kjo situatë duket se i mban marrëdhëniet politike të qeta, bazuar në marrëveshjet e arritura me Titon që në vitin 1955, dhe sjell përqendrimin në zhvillimin e marrëdhënieve ekonomike të cilat po shkojnë mirë. Këto të fundit po përmirësohen në një masë të tillë sa të bëjnë që disa nga miqtë tanë jugosllavë të shqetësohen për përkeqësimin e marrëdhënieve ekonomike me KE-në.

2. Mendoj se do të ishte e çuditshme nëse Moska do të rrezikonte këto tendenca të favorshme duke ndërhyrë në Kosovë dhe në marrëdhëniet e Jugosllavisë me Shqipërinë. Çdo shenjë e përfshirjes sovjetike në këto zona tepër të ndjeshme do të

ringjallte armiqësinë e fshehur jugosllave në drejtim të Bashkimit Sovjetik.

3. Në fakt kemi të dhëna për përfshirje sovjetike. Në fillim të trazirave në Kosovë, deklaratat jugosllave që i referoheshin ndërhyrjes së huaj përfshinin kominformistët. Por, kjo akuzë nuk u mbështet asnjëherë seriozisht dhe, pas artikullit kritik të gazetës "Pravda" në prill, kominformistët nuk janë përmendur në ndonjë deklaratë të rëndësishme. Nëse jugosllavët do të kishin të dhëna për ndërhyrje sovjetike apo nëse do të dëshironin të tërhiqnin vëmendjen në këtë pikë, siç sugjeron edhe Berislavjevic në deklaratën e tij, me siguri që do t'i ishin kthyer kësaj akuze.

4. Për sa i përket përdorimit të mundshëm nga Moska të kartës së Kosovës për të ndikuar në zhvillimet në Poloni, do të mendoja se ata e kanë kuptuar që influenca e Jugosllavisë në Poloni është kaq periferike sa të mos përpiqen ta luajnë këtë rol, veçanërisht kur ajo rrezikon të shqetësojë marrëdhëniet e mira aktuale me Jugosllavinë.

5. Gërliçkov, anëtar i Kryesisë së Partisë, e mohoi në bisedën me mua mundësinë e ndërhyrjes sovjetike në Kosovë më 6 prill (telegrami im nr. 43). Që atëherë kam folur me këshilltarin për Politikën e Jashtme të kryeministrit dhe një zyrtar të lartë të Partisë: të dy më thanë se e dinin që nuk ka të dhëna për ndërhyrje sovjetike. Megjithatë, ky i fundit shtoi se nuk mund të përjashtohet asnjëherë mundësia e përzjerjes sovjetike: ata duhet të kenë lënë pas agjentë në Shqipëri.

6. Një shpjegim i mundshëm për sugjerimet e Berislavjevic dhe drejtimin zyrtar jugosllav (që unë nuk e kam parë ende) mund të jetë që autoritetet jugosllave, të vetëdijshme për disa nga dobësitë në rastin e tyre në Kosovë (veçanërisht mosdhënien e statusit të Republikës) po përpiqen që një pjesë të përgjegjësisë për ngjarjet t'ia kalojnë agjencive të jashtme. Ata janë të shqetësuar për imazhin e tyre jashtë vendit lidhur me trajtimin që i kanë bërë

shqiptarëve të Kosovës. Rusët do të shërbenin si kokë turku e vërtetë.

Bolland

Kopje për:
Stafin e Vlerësimit,
Zyra e Kabinetit.

[Ky telegram nuk është përcjellë]

-43-
Konfidenciale

GR 200
Fm Moskë 261155z, maj '81
Informacion rutinë për FCO
Telegram nr. 295, i datës 26 maj
27 maj 1981
Informacion, Beograd
Telegrami juaj nr. 311

Kosova

1. Besoj se rusët thjesht po vëzhgojnë situatën nga larg. Vlerësimi ynë vazhdon të jetë se është në interesin afatgjatë të sovjetikëve që të ruajnë marrëdhënie korrekte me Jugosllavinë, së paku deri kur të fillojnë të shfaqen mosmarrëveshjet në radhët udhëheqjes jugosllave mbi mënyrën se si do të përballohen problemet e vendit. Raportimi nga ana e shtypit sovjetik ka qenë i shkurtër dhe i vetmi koment ishte mohimi (gazeta "Pravda" e datës 19 prill: shkresa nisur me telefaks e z. Jackson e datës 21 prill) i supozimeve për ndërhyrje sovjetike, gjë që me sa duket i acaroi rusët.

2. Ambasada jugosllave këtu nuk ka bërë më shumë sesa të thotë që rusët nuk janë "të pakënaqur" për trazirat në Kosovë. Ne nuk kemi të dhëna se shembulli jugosllav po bëhet "gjithnjë e më shumë tërheqës" në Evropën Lindore apo se Bashkimi Sovjetik është i shqetësuar për këtë rezultat. Dyshoj se situata është krejt e kundërta - lëvizja Solidariteti është ndoshta vërtet shumë më e pavarur se sindikatat jugosllave. Mbase këto të fundit një ditë mund të tundohen të mësojnë nga përvoja e solidaritetit?

Brooke Turner

Kopje për:
Stafin e Vlerësimit,
Zyra e Kabinetit.

[Ky telegram nuk është përcjellë]



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Mësohen grupet e Copa Americas, debuton Kanadaja

PRISHTINË, 25 MARS - Tashmë dihen katër grupet e edicionit të sivjetmë të Copa Americas që sivjet mbahet në Shtetet e Bashkuara të

Amerikës. Në Grupin A është kampionia aktuale, Argjentina, por dhe Peruja, Kili dhe Kanadaja që luan për

herë të parë në këtë garë. Ndërsa në Grupin B bëjnë pjesë Meksika, Ekuadori, Venezuela dhe Xhamajka. Në Grupin C janë Shtetet e

Bashkuara të Amerikës, Uruguai, Panamaja dhe Bolivia. Kurse në Grupin D janë Brazili, Kolumbia, Paraguai dhe Kosta Rika.



Kosova sot luan për rezultat pozitiv ndaj Hungarisë

BUDAPEST, 25 MARS - Kombëtarja e Kosovës në futboll ka bërë përgatitjet e duhura për miqësoren kundër Hungarisë e cila zhvillohet sonte (e martë) në Budapest.

Kosova në duel me Hungarinë

vjen pas fitores ndaj Armenisë (1-0), miqësore kjo e zhvilluar ditë më parë. Nën drejtimin e përzgjedhësit Franco Foda, lojtarët dardanë, krahas ngrohjeve të zakonshme dhe lojës me top në hapësira të

ngushta, kanë punuar në taktikën që përzgjedhësi Foda ka përgatitur për duelin me hungarezët. Ndeshja Hungari - Kosova luhet në "Puskas Arena" prej orës 19:00.



Drejtuesit e FFK-së vizitojnë Ambasadën e Kosovës në Budapest



BUDAPEST, 25 MARS - Presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi dhe nënkryetari i kësaj federate, Bakir Burri, kanë qëndruar të hënën për vizitë zyrtare në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Budapest. Ata janë pritur nga Naser Idrizi, ministër këshilltar në këtë ambasadë. Presidenti Ademi ka shpalosur hollësi nga qëndrimi dhe mikpritja e mirë e ekspeditës së Kombëtares së Kosovës në Budapest, por edhe

për proceset zhvillimore të FFK-së për krijimin e kushteve sa më të mira për futbollistët. Gjithashtu, i pari i FFK-së ka theksuar rëndësinë e bashkëpunimit me përfaqësitë diplomatike të Kosovës në promovimin e sportit dhe imazhit të vendit në arenën ndërkombëtare. Nga ana e tij, i ngarkuar me punë në ambasadë, Naser Idrizi, ka shprehur kënaqësinë për vizitën e delegacionit të FFK-së dhe ka

siguruar mbështetjen e plotë të ambasadës në të gjitha aktivitetet sportive të Kosovës në Hungari. Ai ua ka përcjellë kërqet e FFK-së përshëndetjet e gjithë personelit të ambasadës, si dhe ka uruar që Kombëtarja e Kosovës të ketë paraqitje dinjitoze në ndeshjen e sotme (e martë) kundër Hungarisë në "Puskas Arena". Në fund, presidenti Ademi për mikpritësin ka dhuruar edhe fanellën e Kombëtares si dhe simbolin e Hyjneshës në Fron.

Nuk u ftua nga Kombëtarja për miqësoret e marsit, flet Mirlind Daku

PRISHTINË, 25 MARS - Kombëtarja e Shqipërisë e ka nisur me humbje vitin 2024, pasi u mund në miqësoren e parë për këtë muaj nga Kili me rezultat 3-0. Dy futbollistët nga Kosova, Arbnor Muja dhe Mirlind Daku, u lanë jashtë listës së Silvinjos për këto dy ndeshje të muajit mars, ndërsa pikërisht sulmuesi që luan për Rubin Kazanin në kampionatin rus, ka thyer heshtjen, duke folur për herë të parë në një intervistë të dhënë për

televizionin "Shenja" në Maqedoninë e Veriut. "Normal edhe unë si futbollist e kam pritur ftesën e Kombëtares, por trajneri është ai që vendosi dhe trajneri ka vendosur kështu kësaj here. Dhe ajo që më ngelet mua është të vazhdoj të punoj, të tregoj rezultate të mira që në tjetrin grumbullim ta kem ftesën. Por, gjithsesi trajneri vendos dhe ai e ka timonin kryesor", është shprehur Daku. Futbollisti i Kosovës gjithashtu



tregon se a ka pasur kontakte me seleksionuesin Silvinjo gjatë kësaj periudhe, para listës ose pas publikimit të listës. "Jo, nuk kemi pasur kontakt, por vetëm në bazë të konferencës për të kuptuar se është ajo arsyeja se pse nuk jam i ftuar në grumbullim", ka thënë Daku. Daku dhe Muja ishin në mesin e futbollistëve të rëndësishëm për Shqipërinë gjatë eliminatorëve të fundit, ku kuqezinjtë siguruan Kampionatin Evropian.


Zidane: Bellinghami është lojtar spektakolar

MADRID, 25 MARS - Në orët e fundit Zinedine Zidane është rikthyer në "Santiago Bernabeu". Trajneri francez, i cili ka fituar tri herë Champions League në bankinën e Real Madridit, ka mbërritur në shtëpinë e "Los Blancos" për të

luajtur një ndeshje miqësore kundër veteranëve të Portos. Dhe rasti ishte i duhuri për t'iu përgjigjur një pyetje në lidhje me ndikimin e Jude Bellinghamit, lojtar anglez i cili që në sezonin e tij të parë me Real Madridin ka zgjedhur

numrin 5 në fanellë, atë që legjenda franceze mbante dikur. "Ai është një futbollist spektakolar. Ne jemi me fat që e kemi në Real Madrid. Ai është shumë i fortë dhe shpresoj se mund t'i sjellë 'Los Blancos' shumë trofe", ka thënë Zidane.





Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook


www.facebook.com/gjeipuneshpeite

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Hazir Thaçi B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e Biznesit me nr. Unik Identifikues: 810010661.

"BurgerBro's" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e Biznesit me nr. Unik Identifikues: 811439927.

Qëndresa Sali Dervishaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e fakultetit të Edukimit, Universiteti "Fehmi Agani", Gjakovë.

Elvane Arllati nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme Gjinnazi "Hajdar Dushi", Gjakovë.

Ukë Dujaka nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl; 10,11,12 dhe diplomën e Gjinnazit "Hajdar Dushi", Gjakovë.

Milit Kastrati shpall te pavlefshme diplomën Q.K "11 Marsi" Prizren.

Avni Tahirukaj shpall te pavlefshme diplomën Q .K "11 Marsi" Prizren.

Festim Likaj shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren.

Elvir Ponik shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën Q.K. "11 Marsi" Prizren.

Rizan Kurtaj shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën Q.K "11 Marsi" Prizren.

Luan Elezi shpall te pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën Q.K. "11 Marsi" Prizren.

Arbër Çuni nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të SH.F.M.U "Mazllum Këpuska". Gjakovë, nga klasa; 1-9.

Marigone Habib Foniqi shpall të pavlefshme Diplomën e Kolegjit "Dardania" Prishtinë.

Kenan Ademi shpall te pavlefshme dëftesën e klasës 10.11.12 te shkollës se mesme "Xheladin Deda".

Ilirjana Fetahu shpall te pavlefshme diplomën e shkollës se mesme "Xheladin Deda".

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Fitore bindëse për Besa Famgasin e Kastriotin

PEJË, 24 MARS - Nuk kanë ofruar shumë rivalitet dy ndeshjet e së dielës, që ishin të vlefshme për xhiron e 22-të të Superligës së Kosovës në hendboll (meshkujt). Kampionia aktuale, Besa Famgas e mposhti në Pejë skuadrën e Vushtrrisë me

rezultat 38:21. Jon Vokshi u shqua te skuadra pejane me plot 14 gola. Arbios Mushkolaj i kishte gjashtë e Antonio Vozila pesë. Shtatë gola për Vushtrrinë i shënoi Fitim Klinaku. Nga katër i kishin Egzon Ademi e Amir Fazliu. Besa është e dyta me 36 pikë.

Vushtrria është e gjashta me shtatë pikë. Ndërkohë Kastrioti ka mposhtur Trepçën në Mitrovicë me rezultat 50:28 dhe doli në pozitën e tretë me 28 pikë. Trepça mbetet me 26 pikë dhe ka rënë në pozitën e katërt. Skuadra mitrovicase e ka një ndeshje më pak të

luajtur. Trepça ka mbetur me fond të limituar lojtarësh dhe nuk ia doli të rivalizoi ferizajasit e mobilizuar. Rron Ramadani i shënoi 11 gola për Kastriotin. Nga gjashtë i kishin Festim Mustafa, Marley Wallace e Deniz Terziqi. Yassine Henahen i shënoi tetë



gola për mitrovicasit. Nga gjashtë i kishin Amar Mujka, Sali Maxhera e Shpëtim Mehmeti.

Ylli me fitore të rëndësishme në Prizren, Vëllaznimi rikthehet në vendin e pestë

"Epoka e re"

PRIZREN, 24 MARS - Golden Eagle Ylli ka shënuar fitore shumë të vlefshme, duke mundur Proton Cable Prizrenin me rezultat 63:96 (16:28, 13:25, 19:22, 15:21), në javën e 27-të të Prince Caffë Superligës. Ndeshja faktikisht është vendosur në pjesën e parë, ku mysafirët që duan pozitën e dytë në renditje, ishin më të motivuar, duke qenë më të mirë në çerekun e parë dhe të dytë, për të shkuar në pushim me rezultat 29:53. Në pjesën e dytë therandasit ruajtën epërsinë dhe madje e thelluan për të fituar 63:96. Isaiah Kelly kishte 17 pikë e 13 kërcime për vendasit, derisa Alonzo Verge Jr 25 pikë, pesë kërcime e katër asistime. Proton

Cable Prizreni mbetet në vendin e shtatë me shtatë fitore e 20 humbje, kurse Golden Eagle Ylli barazohet me pikë me Pejën, nga 18 fitore e nëntë humbje. Vëllaznimi ka shënuar fitore ndaj Istogut me rezultat 97:68 (23:13, 23:14, 26:23, 25:18), në javën e 27-të të Prince Caffë Superligës, duke u rikthyer në vendin e pestë. Ashtu si ishte pritur, kuqezinjtë ishin më shumë të motivuar dhe para publikut vendas u rikthyen te fitorja, ku ishin më të mirë nga fillimi se istogasit për të triumfuar me rezultat 97:68. Daniel Lekndreaj ishte më i miri te vendasit me 31 pikë, 17 kërcime e pesë asistime, derisa Donat Rexhepi shënoi 20 pikë për mysafirët. Vëllaznimi ka 12 fitore e 15 humbje, kurse Istogu

një fitore e 26 humbje. Të shtunën Sigal Prishtina ka triumfuar në derbin ndaj rivalit të vjetër, Pejës me rezultat 88:98 (16:25, 18:25, 25:23, 29:25). Kwame Vaughn ishte më i miri te Peja me 22 pikë, tri kërcime dhe katër asistime, derisa te Sigal Prishtina u dalluan Derrick Wilson me 23 pikë, katër kërcime e dhjetë asistime dhe Diamond Stone me 25 pikë, nëntë kërcime e katër asistime. Trepça po vazhdon me fitore në Prince Caffë Superligë, ku në xhiron e 27-të mundi Bashkimin 92:78 (37:23, 9:25, 23:13, 23:17), që ishte e 20-ta radhazi në elitë. Te vendasit më i miri ishte Drilon Hajrizi me 27 pikë e shtatë kërcime, kurse Isiah Umipig shënoi 22 pikë për mysafirët.



Kosova zhvilloi stërvitjen e parë në Budapest

BUDAPEST, 24 MARS - Nën drejtimin e përzgjedhësit Franco Foda, Kombëtarja e Kosovës ka vazhduar punën me fokus te miqësorja e radhës kundër Hungarisë, që zhvillohet të martën, në orën 19:00, në stadiumin "Puskas Arena" në Budapest. Stërvitja e parë në kryeqytetin hungarez ka qenë një mundësi e mirë për ekipin për të hartuar strategjitë dhe taktikat e lojës për të përballuar me sukses sfidën ndaj një kundërshtari të fortë. Ndeshja me Hungarinë pa dyshim do të jetë një test i vështirë

për "Dardanët", por ata janë të vendosur që në stadiumin e stërmushur me tifozë të japin më të mirën e tyre. Pas stërvitjes futbollistët Lindon Emërllahu dhe Blendi Idrizi kanë shprehur besimin e tyre në ekip dhe në aftësitë e tyre për të luajtur një ndeshje të mirë. Ata besojnë se me përgatitjen e mirë nga stafi teknik, do të arrijnë në rezultat të favorshëm. "Dardanët" sot (e hënë) në orën 17:00 do ta zhvillojnë stërvitjen e radhës dhe të fundit për këtë grumbullim në stadiumin "Puskas Arena".

Shqipëria sonte zhvillon miqësore ndaj Suedisë

STOKHOLM, 24 MARS - Kombëtarja e Shqipërisë sonte nga ora 19:00 do të zhvillojë në stadiumin "Friends Arena" të Stokholmit, testin e dytë zyrtar para fazës së grupeve, të Kampionatit Evropian të futbollit, "Euro 2024", teksa si kundërshtar do të kenë

Kombëtarën e Suedisë, me "Vikingët", që ka jo pak emër në futbollin botëror. Pas përfundimit të konferencës zyrtare për media të trajnerit Silvinjo dhe mesfushorit Ylber Ramadani, skuadra zbriti në fushën e lojës dhe kreu seancën stërvitore në

stadiumin "Friends Arena", duke mbyllur kështu edhe përgatitjet për duelin miqësor ndaj Suedisë, stërvitje që zgjati më shumë se një orë në stadiumin e ndeshjes. Skuadra ka punuar më shumë me topin, pa ngarkesa fizike dhe gjendja e lojtarëve është e mirë. I

gjithë fokusi është vetëm te sfida e dytë miqësore e marsit ndaj Suedisë. Ndërkaq, kujtojmë se kjo është një përballje shumë e rëndësishme për "Legionarët" tanë, që kërkojnë të hedhin "pas krahëve", humbjen katastrofike 0 me 3, ndaj Kilit.







ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

